KATIQISM I VOGËL

Me Proba nga Shkresa e Shenjtëruarë

Shypëshkronja «Tregëtare Kërkombëtare»
1912

BKSH

BIBLIOTEKA
• VANGJEL KOÇA •
TIRANË

KATIQISM

I

VOGËL

Me Proba nga Shkresa e Shënjtëruarë



BIBLIO
• VANGJEL KOÇA •
TIRANË

BKSH

MANASTIR
Shtypëshkronja «Tregëtare Nërkombëtare»
1912

BKSH

KATIQISM I VOGËL

Pyet. 1. Cili është qëllim' i parë i njeriut në botë?

Përgj. Qëllim' i-parë i njeriut është të lavdonjë Perëndinë[1] edhe t'a gëzonjë për gjithënjë[2]

[1] Rom. 11:36. Sepse prej Atij, edhe me anë të Atë edhe në Atë janë të gjitha: mbë Atë qofë lavdia për gjithë jetën! Amën. 1 Kor. 10: 31. Ndë këngërsh pra, a ndë pi, a ndë bësh ndo një gjë, të gjitha bëni për lavdin' e Perëndisë.

[2] Ps. 73:25,26. Kë kam ndë qiell? edhe mbë dhet nuku pëlqenj tjetërë veç teje. S'anë mësi mish e zëmërë; fortesë e zëmrësë s'ime është Perendia, edhe pjesa ime gjithë jetënë.

Pyet. 2. Ç'farë regulle na ka dhënë Perëndia që të na drejtonjë si t'a lavdojmë edhe t'a gëzojmë Atë?

Përgj. Fjal' e Perëndisë, e cila gjendet ndë shkresat e-Shënjtëruara të Dhjatës së-vjetërë edhe të Dhjatës së-re,[1] është e-vetëma regullë që munt të na drejtonjë si t'a lavdojmë Atë edhe t'a gëzojmë,[2]

[1] Luk. 24: 27, 44. Edhe zuri që nga Moisia, edhe që nga gjithë profëtërë e u sqjëllte atyre ato *që ishin shkruar* për atë ndëpër gjithë shkrouajat. Pastaj u tha atyre, kisha *janë ato* fjalë që u fola juve, kur ishnjëm bashkë me ju, se duhej të mbusheshinë gjith'ato që janë shkruarë ndë mont të Moisiut, edhe ndë profitërit, edhe ndë psalmët për mua. 2 Pet. 3: 2, 15, 16. Që të kujtoni fjalëtë që u fola përpara nga profitërit' e shëjtëruarë, edhe porosinë t'onë apostojvet Zotit edhe Shpëtimtarit. Edhe kujtoni zëmërën e gjerë të Zotit t'ënë për shpëtim: sikundër edhe Pavli vëllaj ynë i dashuri u shkroj juve pas dhurisë që i u-

dha ati, sikundrë edhe adë gjithë kartërat *e tia* duke folurë naʼ ato për këto punëra nëër ato janë ca *punëra* që sʼkapërcenenë, të cilatë të paditurivʼe të paqëndruarshëmit i shtrëmbërojënë, sikundrë edhe shkronjatʼ etjera, për humbjenʼ e tyre.

⁵). 2 Tim. 3: 16,17. Gjithë shkronja është frymë nga Perëndia, edhe e dobishme për mësim, për qërtim, për të ndrequrë, për mësim që është me drejtëri: që të jetë i tërë njeriu i Perëndisë, bërë gati për çʼdo farë punë të mirë. Luk. 16: 31. Edhe *ay* i tha, Ndë qoftë se nukë ndigjonjënë Moisinë edhe profiterët, as ndë u-sgjoftë nëonjë nga të vdekurit, sʼkanë për të nënë besë. Gal. 1: 8, 9. Po edhe neve, a ëngjëll nga qiellʼ ndë u lëçitë juve tjetërʼ ungjill përveç ati ungjillit që u lëçitëm juve, qoftë mallkuarë. Sikundrë thamë më përpara, edhe ndashtë përsëri theu, Ndë u lëçitë ndonjë *tjetër* ungjill, përveç ati që kini marë, qoftë mallkuarë. Ioan. 15: 11. Të folа juve këto që të mbesë gëzimi im mbë ju, edhe gëzimi juaj të jetë i ploti.

Pyet. 3. Cilat janë më të shënuarat mësime që na jep Shkresa e-Shënjtëruarë?

Përgj. Mësimet më të shënuara që na jep Shkresa e-Shënjtëruarë janë ato, që na mësojnë si duhet njeriu të mbesonjë Perëndisë⁵) edhe çʼdetyra kërkon Perëndia nga njeriu?

⁵). Ioan. 5: 39. Vështroni skronjat, sepse ju kujtoni se kini jetë të pasurë ndër ato, edhe ato janë që martirisënë për mua. Ioan. 20: 31. Po këto u shkruanë, që të mbesoni se Iisui është Krishti i biriʼi Perëndisë, edhe duke mbesuarë të kini jetë nëʼ emërit tʼAti. 1 Ioan 1: 3, 4. Atë që kemi parë e kemi dëgjuarë, u apinë të juve, që të kini edhe ju pjesë me ne: dhe pjesa jonë të jetë me Atinʼ edhe me Birinʼe Ati, Iisu-Krishtinë. Edhe u shkruajnë juve këto, që të jetë gëzimi juaj i ploti.

⁵). Rom 15: 4. Sepse ca u shkruanë përpara u shkruanë për mësimnë tʼënë, që të kemi shpresënë prej durimit e prej ngushullimit shkrenjavet. 1 Kor. 10: 11. Edhe gjithë këto punë bëcshinë për shëmbëllesa nëʼ ata, edhe u shkruanë për mësimnë tʼënë, nëë të cilët harisë të mbarainëzatʼ e jetëvet.

Pyet. 4. Çʼështë Perëndia?

Përgj. Perëndia është Frymë,[1] që s'ka as të nisurë as të sosurë edhe është i-pakëmbyerë ndë të-qënurit e Tij,[2] ndë urtësi,[3] ndë fuqi,[4] mbë shënjtëri,[5] ndë drejtëri, ndë mirësi edhe ndë të-vërtetë.[6]

[1]) Ioan. 4: 24. Perëndia është frymë, odhe ata që e lusnjënë duhetë t'a lusnjënë me frymë e me të vërtetë.

[2]) Të Dalëtë 3: 14. Edhe Perëndia i tha Moisiut, Unë jam Ay që është: edhe tha, kështu dot'u thuash të bijvet Izraëlit: Ay që është më dërgoj to ju. Ps. 145: 3. I-madh është Zoti e fort i-lavdnuarshëm; edhe madhëria' s' Atë s'i gjëndetë anë. Ps. 90: 2. Para se të lindësh malëtë, edhe të gatuash dherë e botënë, edhe që nga jeta e jetësë, ti je Perëndi. Isk. 1: 17. Ç'do dhëriçje e mirë, edhe ç'do dhuratë e thiesbë është prej së larti odhe zbret nga Ati i dritavet, mbë të cilinë s'ka të ndryrë a hie këmbimi.

[3]) Rom. 11: 33. O thellësinë pasje e dituri e mëtat Perëndie! Sa të pavëshgueshë janë gjyqët e Atë, edhe të pagjetura gjurmat'e udhëvet Atë!

[4]) Të Bërëtë 17: 1. Zoti i u duk Avraamit, e i tha, Unë jam Perëndia Gjithë-pushtetësi: ecë përpara meje, edhe ji i-sosurë.

[5]) Zbul. 4: 8. Edhe nuku kanë të prëjtunë dit' e natë dykë thënë, Shënjt, shënjt, shënjt është Zoti Perëndi Gjithë-pushtetësi, ay që ishte edhe që është edhe që vjen.

[6]) Të Dalëtë 34: 6, 7. Edhe Zoti shkoj përpara ati, odhe thëçiti Zoti, Zoti Perëndi i dhëmpçuri e i përdëlyeshmi, zemërë-gjeti, e përdëllim-madhi, e i vërteti, që ruan përdëllim, për mijëtëve vetа, edhe ndjen pamoni, e pandhëri, e faj, odhe fare nuku nxjen pa faj fajtorinë.

Pyet. 5. A ka më tepër se një Perëndi?

Përgj. Një Perëndi ka vetëm,[1] i gjallë edhe i vërteti Perëndi.[2]

[1]) Nom' i Dytë 4: 4. Pa dëgjo o Israil: Zoti Perëndia yné është një Zot. 1 Kor. 8: 4. E dimë se idhulli s' është fare gjë ndë botët, edhe se nuk'është tjatër Perëndi veç një.

[2]) Jer. 10: 10. Po Jehovah është i vërteti Perëndi; Ay është

i gjallì Perëndi, edhe një Mbret i përjetëshmë: edë zëmërim të tij dhau drithat edhe kombete nuku mund të qëndrojnë përpara zëmërimit Tij. Ioan 17:3. Edhe kjo është jet' e pasurë që të njohim Ty të vetëmin të vërtetin Perëndi, edhe Iisu Krishtin që dërgove.

Pyet. 6. Sa faqesh është Perëndia?

Përgj. Perëndia është tri faqesh: Ati, Biri, edhe Fryma e-Shënjtërnarë[1]. Këta tri veta janë një Perëndi, një ndë lëndë, sinjënjë ndë fuqi edhe lavdi.[2]

[1]. Matt 3:16,17. Edhe Iisaj si u pagëzua përnjëherë dolli nga ujëte edhe ja tek u hapnë qiejtë edhe pa Frymën' e Perëndisë duke zbritarë posi pëllump, e duke zëthurë mbi Atë. Edhe ja tek u dëgjua një zë nga qiejtë që thoshte, Ky është biri im i dashurë që e kam pëlqyerë. Matt. 28:19. Edhe i pagëzoni mbë emërit t'Atit e të Birit e të Frymësë Shënjtërnarë. 2 Kor. 13:14. Hiri i Zotit Iisu Krisht, edhe dashuria e Perëndisë edhe Shoqëria e Frymës së Shënjtërnarë qoftë bashkë me gjithë ju. Amin.

[2]. Ioan 1:1. Që përpara botësë ishte Fjala, edhe Fjala ishte me Perëndinë edhe Fjala ishte Perëndi. Ioan 5:18. Përandaj Judhenjtë më tepërë kërkonin ta vrasënë, sepse jo vetëmë të shkelënë prehtë, po edhe thoshte se Perëndia është i ati, edhe bënte veten' e ti sinjënjë me Perëndinë. Punët 5:3,4. Edhe Pjetri tha, o Anani, përse ushasht zemëra t'ënde Satanai të gënjenç Frymën e-Shënjtërnyerë, edhe të bënç nga të çëmuarat'e arësë. Ç'pate që vure ndër mënt këtë punë, nuku gënjeve njëriut, po Perëndinë. Rev. 1: 3. I cili, duke qënë ndrigim' i lavdisë edhe karakter' i së qënësë Atit.

Pyet. 7. Cilat janë parurdhërimet e Perëndisë?

Përgj. Parurdhërimet e Perëndisë janë gjithë punët, të cilat para se të bënenë, Perëndia i ka pasurë ndër mënt edhe bënenë pas vojësë Tij të përjetëshme edhe për lavdinë e Tij.[1]

[1]. Rom 11:36. Sepse prej Ati edhe me anë t'Atit, edhe ndë Atë janë të gjitha mb' Atë qoftë lavdia për gjithë jetët. Amin.

Ef. 1:11. Mb' Atë mbarnë edhe shortë, ardhërrarë që përpara sikundrë e pat vënë ndër mënt Ay që vepëron të gjitha pas ëndësë dashurimit Ti. Punët 2:23. Këtë që që dhënë pas ëndësë ardhërrarë, edhe pas të paranjoharësë Perëndisë, e zutë edhe me duar të panome e mbërthyetë edhe e vrarë.

Pyet. 8. Si i mbaron Perëndia parardhërimet e Tija?

Përgj. Perëndia i mbaron parardhërimet e Tija ndë punërat e kriesës edhe në punërat të providencës (parë-kujderjes) së Tij.[1]

[1] Zbul. 4:11. I vëyenë je o Zot, të març lavdin' e nderin' e fuqinë: sepse Ti i krinve të gjitha, edhe për dashurimin t'ënt janë, edhe u krijuanë. Dan. 4:35. Edhe të gjithë ndënjësit e dheut nëmëronen për asgjë, edhe Ay punon pas dashurimit të së ushtëri të qiellit, edhe ndërmënt të ndënjësvet dheut: edhe asndo-një nuku mund të ndalonjë dorën e Ti, ose t'i thotë Atë, ç'po bën Ti? Isaia 40:46. Ngrini lart syte t'uaj, e shihni, kush i ka bërë këto: Ay që nxjer ushtëritë atyre me numër: Ay që thërret me emërë këto të gjitha ndë madhërit të fuqisë Ti, sepse është i fortë ndë pushtet: euk' i shtrest gjë.

Pyet. 9. Ç'është krijesa?

Përgj. Krijesa është të bërët'e botësë me gjithë ç'janë nd'atë, prej asgjësendi, të cilat i mbaroj Perëndia me fuqin' e Fjalësë Tij ndë gjashtë dit[1]; edhe i pa që ishinë fort të mira.[2]

[1] Të Bërësë 1:1. Që përpara herësë Perëndia bëri qjellin' edhe dhenë. Hebrenjvë 11:3. Me anë të besësë kuptojmë se jetët u ndërtuanë me fjalën e Perëndisë, kaqë që këto që ishinë nuk' u bënë: prej atyre panëravet që dukenë. Ps. 33:9. Ay tha, edhe u bënë: Ay urdhëroj edhe u ndërtuanë.

[2] Të Bërësë 1:31. Edhe Perëndia pa ëgjithë sa bëri: edhe na tok ishinë fort të mira: edhe u bë mbrëmje, edhe u bë mëngjes, dit' e gjashtë.

Pyet. 10. Si e krijoj Perëndia njerinë?

Përgj. Perëndia e krijoj njerinë burrë edhe grua pas të përgjajturit të Tij,[1] ndë dituri,[2] drejtëri edhe shënjtëri,[3] me fuqi përmbi krijesat.[4]

[1]). Të Bërtë 1:27. Edhe Perëndia bëri njerinë pas të përgjajturit të Ti pas të përgjajturit e Perëndisë e bëri atë: mashkull e femërë i bëri ata.

[2]). Kol. 3:10. Edhe veshtë të rinë që të përtërihetë mbë [illegible] njohurinë pas shëmbëllesës' Atì që e ka krïuarë.

[3]). Ef. 4:24. Të vishni njeriu' e ri, që është adërtuarë pas Perëndisë me drejtëri e me shënjtërin' e së vërtetësë.

[4]). Të Bërtë 1:28. Edhe Perëndia u tha atyre, zotëroni mbi pishqet të detit, edhe mbë shpezët të qiellit, edhe mbë ç'do gjë të gjallë që lëvis mbi dhet.

Pyet 11. Cilat janë punërat e providencës (parë-kujdesjes) së Perëndisë?

Përgj. Punërat e providencës së Perëndisë janë të përkujdesurit edhe të qeverisurit e gjithë krijesavet si edhe punëravet të tyre,[1] me shënjtëri,[2] me urtësi[3] edhe me fuqi.

[1]). Hebrejt 1:3. Edhe duke mbajturë të gjitha me fjalën e fuqisë Ti. Nehemia 9:6. Ti je Jehova, edhe vetëm Tij; Tij bëre qiellin, qiellin e qiejvet, me tërë ushtërinë e tyre, dhenë edhe të gjitha gjerat që janë përmbi të, detet edhe të gjitha, sa janë ndër ato; edhe Tij përkujdesesh për të gjitha këto, edhe ushtëria e qiellit të falet Ty. Matt 10:30. Po juve edhe gjithë qimet' e kresë janë numeruarë.

[2]). Ps. 145:17. Zotë është i drejtë mbë gjithë udhët e Tia, edhe i mirë mbë gjithë punët e Tia.

[3]). Ps. 104:24. Sa u madhuanë punët e Tua, o Zotë! të gjitha i bëre me dituri.

Pyet. 12. Ç'farë punë të-veçantë të providencës tregoj Perëndia përmbi njerinë ndë gjëndjen ndë të cilën e krijoj?

Përgj. Perëndia si e bëri njerinë bëri dhjatë të përjetëshme me atë që ti bindetë më ç'do punë edhe e porositi të mos hajë nga druri i të njohurit së mirës' edhe së keqesë, duke thënë atij, se ndë shkeltë këtë porosi dotë vdesë.[1]

[1]. Gall. 3:12. Edhe nomi nuk'është prej besësë: po njeriu që i bën ato, dotë ronjë prej atyreve. Të Bërët 2:17. Nga ç'do dru të kopshtit të hash lirueshë; po nga druri të njohurit së mirësë e së keqesë mos hash nga ay: sepse atë ditë që të hash nga ay dotë vdesç pa dyshim.

Pyet. 13. A qëndruan përinderit t'anë të parë të pafajmë sikundrë qenë kur i bëri Perëndia?

Përgj. Përinderit t'anë të parë, duke qënë të-liruarë së dashjen e tyre, ranë nga gjëndja që u-krijuan duke bërë faj kundrë Perëndisë.[2]

[2]. Rom. 5:12. Përandaj sikundrë prej një njeriu hyri faji ndë botën. Të Bërët 3:6. Edhe gruaja pa, se druri ishte i mirë mbë të gjithë, edhe ishte i pëlqyerë ndë syt, edhe një dru i dëshëmtueshëm që ep mëndt: edhe ajo mori prej pemës' atë, edhe bëngri: edhe i dha edhe burrë saj bashkë me veten'e saj, edhe ay hëngri.

Pyet. 14 Ç'do me thënë faj?

Përgj. Faj është ç'do gjë që shkel ose nukë-mbush nomnë të Perëndisë[3]

[3]. Rom 4:15. Sepse atje ku s'ka nom, s'ka as të dalë jashtë nomit. Iak. 2:10. Sepse ay që të ruanjë gjithë nomnë e-dhe të fëjenjë mbë një punë është bërë fajtuar i të gjithave. Iak. 4:17. Kush dí pra të bënjë mirë, e nukë bën është faj për atë. Ioan. 3:4. Kushdo që bën fajisë, bën edhe paronimi: se-spe faji është paronimi.

Pyet. 15. C'faj bënë përindërit t'anë të-parë që të bijen nga gjëndja që u krijuan?

Përgj. Faji që bënë përindërit t'anë të-parë që të bijen nga gjëndja që u krijuanë ishte të ngrënit e pemës së drurit, që i porositi Perëndia të mos hanë.[1]

[1]) Të Bërëtë 3: 12, 13. Edhe Adhami tha, Gruaja që më dhe të jetë heshtë me mua, ajo më dha nga druri, edhe hëngra. Edhe Zoti Perëndia i tha gruasë, Ç'është kjo që bëre? Edhe gruaja tha, Gjarpëri më gënjeu, edhe hëngra.

Pyet. 16. A ranë njerëzia në faj të parë të Adhamit?

Përgj. Po, ranë; sepse dhjata, që ishte bërë me Adhaminë, nukë ishte bërë vetëm për atë, po edhe për gjithë farën e atij;[1] përandaj ç'do njeri, që ka lindurë nga Adhami[2] është ndënë fajin që bëri Adhami.[3]

[1]) Të Bërëtë 1: 28. Edhe Perëndia i bekoj ata, edhe Perëndia u tha atyre, Shtohi e shumohi, e mbushni dhenë, edhe ardhëroni atë, edhe zoteroni mbi pishqet të detit, edhe mbi shpezët të qiellit, edhe mbi ç'do gjë të gjallë që lëvis mbi dhet.

[2]) Punët 17: 26. Edhe bëri ç'do komp njerëzish prej një gjaku, që të rrinë mbi gjithë faqen e dheut, edhe ardhëroj kohëratë që i ka vënë nëë taks që përpara, edhe sinoret e së ndërjetës' atyreve.

[3]) 1 Kor. 15: 21, 22. Sepse sikundrë vdekja erdhi nga njeriu, kështu edhe të ngjallurit prej së vdekurish erdhi nga njeriu. Sepse sikundrë të gjithë vdesënë mbë Adhaminë, kështu edhe të gjithë duhë marënë jetë mbë Krishtinë.

Pyet. 17. Ndë çfarë gjëndje e solli njerëzinë të rënit.

Përgj. Të-rënit e solli njerëzinë ndë një gjëndje faji edhe mjerimi.[1]

[3]. Rom. 5:1 ;13. Përandaj sikundrë prej një njeriu hyri faji në botët, edhe prej fajit hyri vdekja, edhe kështu shkoj vdekja mbëpër gjithë njerëzit, sepse të gjithë, fëjerë Sepse gjer ade kohë të nomit qe faji në botët: po për faj nuku numëronetë kur s'ka nom.

Pyet. 18. Ndë se qëndron faji i njeriut, që ka ardhurë me të fëjyerit të Adhamit?

Përgj. Faji i njerit që ka ardhurë me të fëjyerit' e Adhamit qëndron ndë të humburit e drejtërise parë, ndë prishjet të naturës tërësisht, edhe i cili faj radhazi quhet faj'i parë, dhe proj të cilit mbucojnë gjithë paudhëritë.[1]

[1]. Rom. 5:18,19. Sikundrë gra proj një faji u bë dënim mbë gjithë njerëzit, kështu edhe proj një drejtimi u bë mbë gjithë të dalëtë të drejtë për jetë. Sepse sikundrë nga të pa dëgjuarat e një njeriu bënë fajtorë të shumët kështu edhe nga të dëgjuarët e njërit dotë bënesë të drejtë të shumëtë. El 2:11. Edhe u dha fjalë javë që ishitë të vëçkurë për kapërcimin e porosivet e për fajet. Rom. 9:7,8. Sepse mendimi i mishit ishi' armiqësi te Perëndia: sepse nuku bindetë ndë nomi të Perëndisë, po as nuku mant.

Pyet. 19. Ç'është njerimi i gjëndjes ndë të cilën ra njeriu?

Përgj. Tërë njerëzia me anën e të-rënit tyre humpnë shoqërinë me Perëndinë[2] edhe janë ndjetë zëmërimin edhe mallkimin e Tij;[3] edhe kështu janë në rrezik të trashëgojnë tërë njerimet e këtaj jete: vdekjen edhe dhëmbjet e skëterës për gjithë jetën.[4]

[2]. Të Bërëtë 3:8,24. Edhe dëgjuanë zëri' o Zotit Perëndisë tek po ecëntë ndë kopshtë mbë zëmërë herë: Edhë u ishinë Adhami edhe gruaja e ati proj faqes së Zotit Perëndisë, ndërmest të drurëvet kopshtit. Edhe dëboj Adhamnë: edhe ndë

kopësht të Edhemësë nga të lindurit' e djellit vuri Qerovimëtë, edhe kordhën e flakëtë që sillej rotullë, që të ruanin' udhën' e drurit jetësë.

[3]). Ef. 1:3. Ndër ata edhe neve të gjithë u përzjem njëherë pas dëshërimevet mishit t'ënë, duke bërë dashurimin'e mishit edhe mendimevet: edhe ishim nga fisi djemt' e zëmëratësë, sikundrë, edhe të tjerë.

[4]) Rom. 6:23. Sepse paga e fajit është vdekja. Mark 9: 47,48. Edhe ndë të skandalisetë syri yt, nxire: është më mirë për ty të hysh me një sy ndë mbretërit të Perëndisë, se duke pasurë dy sy të hidhesh ndë gjehenë të zjarit: atje ku krimb' i atyreve s'ka të mbaruarë, edhe zjari s'ka të shuarë.

Pyet. 20. A e la Perëndia tërë njerëzinë të humbasinë ndë gjëndjet të fajit edhe të mjerimit?

Përgj. Perëndia nga mirësia e Tij e përjetëshme zgjodhi ca njerës për jetë të-pasosurë,[1] edhe hyri ndë një dhjatë hiri me ta, që t'i shpëtonjë nga qënja e fajit edhe e mjerimit edhe t'i sjellë ata mbë gjëndjet të shpëtimit me anë të një shpëtimtari.[2]

[1]). Ef. 1:4. Sikundrë na zgjodi me anë t'Ati përpara se të egzihej bota, që të jemi shënjtorë edhe faqebardhë përpara Atit me anë të dishurisë.

[2]). Tit. 1:2. Për shpresën' e jetësë pasosurë, që ka zotuarë Perëndia që s'gënjen përpara motevet pasosurë. Tit. 3:7. Që të dalemë të drejtë me hirin' e Ati, e të bënemi trashëgimtarë pas shpresësë jetësë pasosurë. Ioan. 17:6. Emërinë t'ënt u a dëftova atyre njerëzvet që më dhe prej botësë. Të t' ulë i-shinë edhe m'i dhe, edhe ruajtinë fjalësë t'ënde.

Pyet. 21. Cili është Shpëtimtar' i të-zgjedhurvet të Perëndisë?

Përg. I vetëmi Shpëtimtar i të-zgjedhurvet të Perëndisë është Zoti Iisu Krisht,[2] i cili, duke qënë

Biri i-përjetëshmë i Perëndisë u bë njeri,[4] edhe kështu ishte edhe është Perëndi edhe njeri me dy natura të çquara, po gjithë ay vetë[5] një i-përjetëshmë.[6]

[3]. 1 Tim. 2:5. Sepse një është Perëndia, një dhe' edhe mestori i Perëndisë edhe i njerëzvet, njeriu Iisu Krishti.

[4]. Ioan 1:14. Edhe Fjala u bë mish edhe ndënjë ndër ne, edhe panë lavdin e Atë, posë lavdi të-vetëm lindari prej Atë, plot me hir e me të vërtetë.

[5]. Rom. 8:3. Të cilëvet janë atërit, edhe prej atyreve lindë Krishti pas mishit, i cili është përmbi të gjitha Perëndi i bekuarë për gjithë jetët. Amin. Kol. 2: 9. Sepse tek Ay ri gjithë të mbushurit e Hjerisë trupërisht.

[6]. Hëvrejtë 13:8 Iisu-Krishti është Ay vetë dje edhe sot, edhe për gjithë jetët.

Pyet 22. Si u bë njeri Iisu Krishti, duke qënë i Bir' i Perëndisë?

Përgj. Iisu Krishti, i Bir'i Perëndisë, u bë njeri duke marë ndë vete një trup të vërtetë[1] edhe një shpirt të arësyeshmë,[2] duke u zënë me fuqinë e Frymës së Shënjtëruarë nbë bark të vërgjëreshës Maria, edhe u lint prej asaj,[3] i-pafajmë.[4]

[2]. Hëvrejtë 2:14. Edhe sepse çunatë kanë marë bashkë mish edhe gjak, edhe Ay mori gjesë prej atyreve posi ata që të prishinjë me anë të vdekjesë atë që ka pushtetin' e vdekjës së domethënë djallinë.

[1]. Matt. 26:38. Atëhere u thot' atyre. Spirti im është i hidhëruarë gjer nbë vdekje; mbetuni këtu edhe rini sgjuarë bashkë me mua. Luka 2:52. Edhe Isaj vinte mbarë ndë ditari e ndë moshë e ndë hir pranë Perëndisë e njerëzish.

[3]. Luka 1:31,35. Edhe ni të dotë mbarcosh ndë bark, edhe dotë pjellç djalë, edhe dot'ja quanç emërin Iisu. Edhe ëngjëlli u-përgjeq e i tha, Fryma'e Shënjtëruarë dotë vinjë mbi ty, edhe fuqi e të Larti dotë të hieroinje: përandaj edhe ajo foshnj' e shënjtëruarë që len prej teje, dotë quhetë Bir' Perëndie.

[3]. Hevr. 4:15. Sepse s'kemi një kryeprift që nuk mund t'i vijë keq për dobësirat t'ona, po që ngarë më të gjitha posi neve po ligj.

Pyet. 23. Ç punë mbaron Iisu-Krishti si Shpëtimtari ynë?

Përgj. Krishti, si shpëtimtari ynë mbaron punërat të një profiti,[1] të një prifti,[2] të një mbreti,[3] si në gjendje të Tij të përunjurë, kështu, edhe në gjendje të Tij të lartër.[4]

[1]. Punët 3:22. Moisiu u tha etërvet t'anë, Se Zoti Perëndia juaj dot'u ngrerë juve një profit nga vëllezërit t'ajë, posi mua: Atë i dëgjoni mbë të gjitha sa që t'u flasë juvë.

[2]. Hevr. 5:5,6. Kështu edhe Krishti nuku lavdoj vetëhen' e Tij të bëntë kryeprift, po Ay që i foli Ati, Bir im ju Tij, unë sot të kam gjenë. Sikundrë edhe mbë tjetër vent thotë, Tij je prift për gjithe jetënë pas taksit Melqisedhekut.

[3]. Ps. 2:6. Po unë vura mbretnë t'im mbi Sionë, mbë malt t'in të shënjëruarë. Ioan 1:50. Nathanaili u-përgjeq e i thotë, Rabbi, Tij je i Bir'i Perëndisë, Tij je mbret'i Izraillit.

Kyet. 24. Si mbaron Krishti punën e profitit?

Përgj. Krishti e mbaron punën e profitit duke na çfaqur me anë të fjalës' edhe të Frymës së Tij[1] dashurinin e Perëndisë për shpëtimin t'onë.

[1]. Ioan. 1:18. Asndonjë s'e ka parë kurë Perëndinë: veç i vetëm-linduri Bir, që është mbë gjirë Atit, Ay na e dëftëu. Hevr. 1:1,2. Perëndia si u foli një herë motë etërvet t'anë me anë të profitërvet shumë herësh edhe shumë mëndyrësh, na foli edhe neve mbë këto ditë të pastajme me anë të Birit të cilin e bëri trashëgimtarin e të gjithëve, që me anë t'Atij bëri edhe jetët.

[2]. Ioan 14:26. Po Ngushëllimtari, Fryn' shëjtëruarë, që Ati dot a dërgonjë mb'emërit t'im, Ay dot'u mësonjë juvë

të gjitha, edhe dot u bjerë Shpirtit Jinë nëpër mënt gjithë sa u kam thënë juve. Jona 16:13. Po kur të vinjë Ay, Frym' e Së vërtetës, dot' u bojnjë udhëtë juve mbë gjithë të vërtetënë.

Pyet. 25. Si e mbaron Krishti punën e priftit?

Përgj. Krishti e mbaron punën e priftit me të-bërit një herë të vetës së Tij kurban për të kënaqyrë drejtërin' e Perëndisë,[1] edhe për të na pajtuarë me Atë,[2] duke qënë mesësi ynë për gjithënjë.[3]

[1]. Hevr. 9: 28. Kështu edhe Krishti një herë u pru kurban që të ngrerë fajet e të shumëtvet. Rom, 3:26. Për të dëftyerë drejtërin' e Atë ndë këtë kohë, që të jetë Ay i-drejtë, edhe të ejerë të drejtë atë që i beson Jesuit. Rom. 10:4. Sepse të mbetuarit' e romë është Krishti për drejtëri të cilido që mbeson.

[2]. Hevr. 2:17. Përandaj duhej t'u ngjasnte vëllezërvet mbë të gjitha, që të bëhej kryeprift i-dhëmbur edhe besëtar mbë punëtë të Perëndisë, që të qërenjë fajet e Jaonit (komëtit).

[3]. Hevr. 7:25. Edhe përandaj mund t'i shpëtonjë fare ata që afrohenë prenë Perëndisë me anë t' Atij, sepse ron përherë që të lajmëtonjë për ata.

Pyet. 26. Si e mbaron Krishti punën e mbretit?

Përgj. Krishti e mbaron punën e mbretit, duke na paturë ndënë pushtet të Tij,[1] duke na mprojturë edhe qëverisurë, duke ndaluarë edhe duke mundurë t'ësë armiqt' e Tij edhe t'anët.

[1]. Ps. 110:3. Komëti yt dotë jetë i-gatëshëm ndë ditët të fuqisë s'ate.

[2]. Punët 2:36. Lef' a dijë pra fort mirë gjithë shtëpia e Israilë, se këtë Isunë që ju e kryqëzuatë, Perëndia e bëri Zot edhe Krisht. Posië 16:9,10. Edhe Zoti i tha Pavlit natënë ndë ëndërë, Mos u frikëso, po folë, edhe mos pushoo: sepse unë jam bashkë me ty, edhe os ndonjë nukë dotë vërë dorë mbi ty, që të të bënjë keq: sepse kam shumë njerës ndë këtë qytet.

Pyet. 27. Mbë se qëndron të përunjurit e Iisu Krishtit?

Përgj. Të përunjurit e Iisu Krishtit qëndron në lindje të Tij, e cila, si pas nomit,[a] ngjau më një mësnyrë shumë të përunjurë.[b] Përsëri, të përunjurit e Iisu Krishtit qëndron ndë të pësuarit e mjerimevet të kësaj jete[c] edhe ndë zënërim të Perëndisë,[d] edhe në të mallëkuarën vdekje mbë kryqt[e] duke u varuarë edhe duke ndenjurë ndënë fuqinë e vdekjes për pak kohë.[f]

[a] Gal. 4:4. Po kur erdhi të mbushurit e kohëse, Perëndia dërgoj të Birinë, që lindi prej gruaset edhe që qe ndënë nom.

[b] Luka. 2:7. Edhe polli bir' e saj të-parilinduriné, edhe e mbështolli ndë shpinjesë, edhe e vari ndë grashtë; sepse nukë kishinë vënt atje ku kishinë rrnë. Fil. 2:7. Po zbrazi veten' e Tij edhe mori formë shërbëtori e u bë posi njerëzit mbë të përngjajtarë.

[c] Isaia 53:3. Zbuë për asgjë i hedhurë tej nga njerëzitë: njeri me shtrëngime, edhe i provuarë nga sëmundë jete: edhe posi njeri që kthejnë fytyrë proj Atij, nuka u za për gjë edhe e kajtuam Atë për asgjë.

[d] Matt. 27:46. Edhe mbë të nëntën orë Iisuj bërtiti me zë të math, duke thënë, ILÍ, ILÍ, lama sabahthani? që do me thënë, Perëndia im, Perëndia im, përse hoqe dorë proj meje?

[e] Gal. 3:13. Krishti na çpërblcu nga mallëkim'i nomit, sepse u bë mallëkim për ne: sepse është shkruarë, I mallëkuarë është cilido që varetë mbë drut. Fil. 2:8. Edhe u gjënt posi njeri ndë fytyrë: unji veten'e Tij, e ubë i dëgjuarshim gjer mbë vdekje edhe vdekje kryqi.

[f] 1 Kor. 15:3,4. Sepse u dhashë juve më përpara së që mora edhe unë, se Krishti vdiq për fajet t'ona, pas shkrimjavet edhe se u kall ndë vorr, edhe se u ngjall të tretënë ditë pas shkrimjavet.

Pyet. 28. Mbë se qëndron lartësia e Krishtit?

Përgj. Lartësia e Krishtit qëndron ndë të ngjalluritë e Tij prej së vdekurish të tretën ditë,[1] ndë tënaltësuarit e Tij ndë qiell, ndë të ndenjurit e Tij mbë të-djathtë të Atit,[2] edhe mbë të ardhurit e Tij përsëri për të gjykuarë botën ndë ditën e pastajme.[3]

1. 1 Kor. 15:4. Ay u-ngjall të tretënë ditë.

2. Ef. 1. 20. E ngjalli prej së vdekurish: edhe e vuri të djathtën e Tij mbë qiellorët.

3. Punët 17:31. Sepse vuri një ditë mbë të cilënë është gjykonjë botënë me drejtëri me anë të një njeriu që e ka urdhënuarë, edhe për këtë dha besë mbë të gjithë, kur e ngjalli prej së vdekurish.

Pyet. 29. Si bëhemi pjesëtarë të çpërblimit që u-bë me anë të Krishtit?

Përgj. Na bëhemi pjesëtarë të çpërblimit të Krishtit me anë të fuqisë të Frymësë së Shënjtëruarë,[1] e cila vepëron mbë ne,[2] që të fitojmë këtë çpërblim.

1. Tit 3:5,6. Pas përdëllimit Tij na shpetoj prej së larësë të lindurit përsëri, edhe prej të përtëritjurit Frymësë Shënjtëruarë qëdërdhi mbi ne me dorë të hapëtë, me anë të Jesu-Krishtit Spëtëmarit t'onë.

2. Joan 1:12. Edhe sa e pritën atyre u-dha pushtet të bëhenë bij Perëndie, atyreve që besojënë mbë emërit t' Atij. Joan 3:5,6. Jesuj u-përgjeq, Me të vërtetë metë vërtet po të thonë mos lintë njeri prej uji e prej Frymësë, s'mund të hyrjë ndë mbretëri të Perëndisë. Ç'është lindurë prej mishit, është mish: çësh- të lindurë prej Frymësë, është frymë.

Pyet. 30. Si punon Fryma e Shënjtëruarë ndër ne që të marim çpërblimin që u-bë me anë të Krishtit?

Përgj. Fryma e Shënjtëruarë mbjell besë brënda ndë ne që të na begë të presim çpërblimin' te Jesu-

Krishtit, edhe me anën të asaj na lith me Jesu Krishtin me të thirurit t'onë të vepëruarshim.[1]

[1]. Ef. 4: 15, 16. Të ritemi tek Ay nbq të gjitha, i cili është kryetë do me thënë Krishti, prej Atij gjithë trupi përmbledhurë bashkë e lidhurë bashkë me ç'do të pershtuarë të afyre çopavet që penojnë bashkë, pas vepërimit me masë të gjithesëcilës'asë, bën të riturit'e trupit, për të ndërtazil'e tij me dashuri. Gal. 2: 20. Ü-kruqëzuoshë bashkë me Krishtinë: edhe usë më s'rorj, po Krishti ron tek usë: edhe ajo që rorj anë nëashtì ndë mishi, rorj ndë besë të birit Perëndisë, i cili më deshi, edhe dha ndër dasi vetheu'e Tij për mua.

Pyet. 31. Ç' është të thëriturit e vepëruarshimë?

Përgj. Të-thëriturit e vepëruarshimë është puna e Frymës Perëndisë, që na bint për fajin edhe për mjerimin t'onë, duke na ndrituarë mëndjet ndë të njohurit e Krishtit edhe dyke na përtërituarë vojat t'ona na nangas e na bën që të pushtojmë lisç.-Krisrinë, i-cili na ep liruarë në Ungjill.[1]

[1]. 2 Thes 6: 13 Se Perëndia u sgjodhi juve që përpara herës për shpëtim me shënjtërimin'e Frymësë, edhe me besën'e së vërtetësë. Punët 2: 37. Edhe si dëgjuan këto u-thynë zëmërat e atyre, e i thonë Pietrit edhe apostojvet tjerë, Ç'të bëjmë, o bura vëllezër? Punët 26: 18. T'u hapç sytë atyre, që të kthenësë nga errësira nbe dritët, edhe nga gushtet'i Satanajt te Perëndia, që të marësë ndjesë fajesh, edhe pjesë ndërmest të shënjtuarëvet, me anë të besësë që është mbë mua. Ezeq. 36: 26, 27. Edhe një zemërë të re dotë të ap ty, edhe një frymë të re dotë vë ndë ty; edhe dotë nxjer zemërën'e gurtë prej mishit t'ënt edhe dotë të ap një zemër proj mishi. Edhe dotë vë ndë ty Frymën t'ime, edhe dotë të bëaj ty të ecësh në vendimet e mija, edhe tij dotë ruash urdhërimet e mija edhe dot'i mbushësh ato. Fil. 2: 13. Sepse Perëndia është Ay që vepëron ndër ju edhe të dashurit' edhe të vepëruarit, pas të gëqyerit e tij.

[1] Ioan 6:37:44,45. Gjithë ç'më ep Ati, dotë vinjë tek unë: edhe atë që të vinjë tek unë nukë dot' a nejer jashtë. As adonjë s'mund të vinjë tek unë, ndë mos e heqjë Ati që më ka dërguarë: edhe unë dot' a ngjall ndë ditë të pastajme. Është shkruarë ndë profitërit. Edhe gjithë dotë jenë të mësuarë nga Perëndia. Kushdo pra që ka dërgjuarë prej Atit edhe është mësuarë, vjen tek unë.

Pyet. 32. Ç'fitime kanë ndë këtë jetë ata që janë thirurë me të vërtet?

Përgj. Ata që janë me të vërtet të-thirurë ndë këtë jetë fitojnë të-dalët të drejtë,[1] birërinë,[2] e shënjtërinë, edhe disa të tjera fitime, së-cilatë ndë këtë jetë shoqëronjëanë fitimet që më sipër, ose mburojnë nga ato.[3]

[1]. Rom. 8:30. Edhe sa thirë i mësoi të drejtë.

[2]. Ef. 1:5 Na mëshëroj që përpara për birërí mbë veten e Tij me anë të Jesu Krishtit, pas së pëlqyerësë dashurisë Tij.

[3]. Edhe ju jeni nga ay mbë Jesu Krishtinë, i cili u bë mbë ne dituri nga Perëndia, drejtëri edhe shënjtërim edhe çpërblim.

Pyet. 33. Ç'është të dalit të-drejtë?

Përgj. Të dalit të drejtë është një vepërim i hirit të-liruarë të Perëndisë, me anën të të cilit ay na fal tërë fajet t'ona,[1] edhe na pret si të-drejtë përpara syvet Tij,[2] vetëm me anë të drejtërisë të Krishtit, që nëmërohet t'ona,[3] edhe na e presim vetëm me anë të besës.[4]

[1]. Ef. 1:7. Që prej Atij kemi të çpërblyerësë me anë të gjakut Atij, ndjesën e fajeve, pas gasjesë hirit Atij.

[2]. 2 Kor (5) 21 Sepse Perëndia bëri fajtuar për ne Atë që s'njohu faj, që të bënemi drejtëria e Perëndisë prej Atij. Rom 3: 4 Po dalëmë të drejtë me birin' e Atij që fal me anë të çpërblimit që është mbë Jesu Krishtinë

[1]. Rom. 4:6. Sikundrë edhe Dhavidhi thotë të lumëzuarit' e Atij njeriu, të cilit Perëndia i numëron drejtërinë pa punëra. Rom 5:18 Kështu edhe prej një drejtërimi u-bë mbë gjithë të dalinë të drejtë për jetë.

[2]. Gal. 2:16 Dyke dituri se s'dei i drejtë njeri nga punërat' e nomit, veç me anë të besësë Iisu Krishtë, edhe neve i besuam Iisu Krishtij, që të dalëmë të drejtë prej besësë Krishtit, e jo prej punëravet nomit: sepse asnjonjë njeri s'ka për të dalë i drejtë nga punëra' e nomit.

Pyet. 34. Ç'është birëria?

Përgj. Birëria është një vepërim i hirit të liruarë të Perëndisë,[1] me anën e të-cilit pritemi ndë numurit edhe kemi të-plotë të-drejtë mbë tërë dhuratitë të bijvet të Perëndisë.[2]

[1]. I Ioan 3:1. Shihni ç'farë dashuri na ka dhenë Ati, që të quhemi djemt' e Perëndisë.

[2]. Joan 1: 1,2. Edhe sa e pritë, u dhä pushtet të bëmenë bij Perëndia, atyreve që besojnë mb' emërit të Atij. Rom. 8:17. Edhe ndë qofshim bij, jemi edhe trashëgimtarët: trashëgimtarët' e Perëndisë, edhe trashëgimtarë bashkë me Krishtinë.

Pyet. 35. Ç'është shenjtërimi?

Përgj. Shenjtërimi është një vepërim i hirit të-liruarë të Perëndisë,[1] me anën të-cilit jemi tëpërtëritur ë përgjithësisht si njerës, jemi bërë si pas shëmbëllimit të Perëndisë,[2] edhe forcuarë më tepër e më tepër të jemi të vdekur përpara fajit edhe të rojmë ndë drejtëri.[3]

[1]. I Pet. 1:2. Të sgjedhurëve pas të parënjohurësë Perëndisë Atit, me anë të shënjtërimit Frymësë, për dëgjim e për të'përshkuarë të gjakut Iisu Krishtit.

[2]. Ef. 4:24. E të vishni njerin e ri, që është ndërtuarë pas Perëndisë në drejtëri e në shënjtërim e së vërtetësë.

[3]. Rom. 6:6 *Se* t'ajtëri njeriu ynë ukryqëzua bashkë, që të prishetë trupi i fajit, që të mos i shërbejmë më fajit.

Pyet. 36. Cilat janë të-mirat, që-ndë këtë jetë-shoqërojnë ose mburojnë nga të dalit të drejtë, nga birëria, edhe nga shënjtërimi?

Përgj. Të mirat, të cilat ndë këtë jetë shoqërojnë ose mburojnë nga të dalit të drejtë, nga birëria edhe nga shënjtërimi janë: siguria e dashurisë Perëndisë, pajtimi i ndërgjegjes, gëzimi ndë Frymën e Shënjtëruarë,[1] të-shtuarit e hirit,[2] edhe të qëndruarit ndë këto gjer ndë funt.[3]

[1]. Rom. 5:1,2,5. Së duzëmë gra të drejtë prej besësë, kemi paqtim te Perëndia me anë të Zotit t'onë Jesu Krishtit, prej të cilit kemi edhe të hyrëtë me besënë ndë këtë hir që qëndrojmë mb' Atë edhe mburemi mbë shpresën e lavdisë Perëndisë. Edhe shpresa nuku turpëron, sepse dashuria e Perëndisë është derdhurë ndë zëmërat t'ona me anë të Frymësë Shënjtëruarë që na është dhënë. Rom. 14:17. Sepse mbretëria e Perëndisë nuk'është të ngrën' a të pirë, po drejtëri e gaqtim e gëzim ndë Frymë të Shënjtëruarë.

[2]. Joan 1:16 Edhe nga të mbushurit'e Ati neve të gjithë nxamë edhe hir ndë vënt hiri.

[3]. Fil. 1:6. Sepse më është mbushurë mëndja për këtë se Ay që zuri të bëngë punë të mire ndër ju, dot'a mbaronjë gjer ndë ditë të Jesu Krishtit. 1 Pet. 1:5. Që me fuqin'e Perëndisë mbetemi me anë të besësë, për shpëtim të gatishmë të shuloretë ndë koh'e postinjur.

Pyet. 37. Ç' të mira marin besëtarët nga Krishti pas vdekjes?

Përgj. Shpirtrat e besëtarëvet pas vdekjes bëhen të-sosura ndë shënjtëri,[1] edhe përnjëherë hyjnë ndë lavdi;[2] edhe trupat e tyre dyke me qënë bashkuarë me Krishtinë,[3] prëhen ndë vart gjer ndë të ngjallurit prej së vdekurish[4].

[4]. Zbul. 14:13. Edhe dëgjova një zë nga qielli që më thoshte, Shkruaj, Lum ata të vdekurë, që vdesënë mbë Zotinë që tashi. Po, thotë Fryma, që të pushoné nga mëndiet' e tyre: edhe punëtat' e atyreve u venë prapa atyreve. Zbul 19: 8. Edhe u dha asaj që të vishetë me vishnjë të pastrë e të ndritunë: sepse vishnjeja është drejtëria e shënjtorëvet.

[5]. Luk. 23:43. Edhe Iisuj i tha Me të vërtetë po të them Sot dotë jesh bashkë me mua ndë parrdhis. Punët 7:55,59. Po ay që ishte plot me Frymë të Shënjtëruarë, shtyri sytë ndë qiell, e pa lavdin' e Perëndisë edhe Iisunë ndënjerë prej së djathtësë Perëndisë. Edhe i shtirinë me gurë Shtefanit, që lutej e thoshte, o Zot Iisu, prit shpirtinë t'im. Fil. 1:23. Sepse shtrëngonem prej së dyjash, dëshirimin' e kam për të ikurë, edhe të jem bashkë me Krishtinë: sepse është shumë më mirë. 2 Kor 5: 8. Përandaj kemi zëmërë dhë na pëlqen më tepër të jemi larg trupit, e të jemi afërë Zotit.

[6]. 1 Thes 4:14. Kështu edhe Perëndia dotë i bjerë bashkë me Atë ata që kanë fjeturë me anë të Iisujt.

[7]. Ioan 5:28. Se vjen një orë që ndë atë gjithë ata që janë adëpër varret dotë dëgjojnë zërin' e Atij.

Pyet. 38. Çfarë mira marin besëtarët nga Krishti ndë të-ngjallurit prej së vdekurish?

Përgj. Ndë të ngjallurit prej së vdekurish besëtarët duke u-ngritur ndë lavdi,[1] do të njihen çfaqurë, dotë lëshohen ndë ditën e gjyqit,[2] edhe dotë bëhen të sosurë në Jamëri, ndë gëzim të plotë të Perëndisë për gjithë jetënë.[3]

[1]. Kor. 15:43. Mbilotë e pandërçime e ngritetë ndë lavdi.

[2]. Matt. 10:32. Kushdo pra që të më rëfenjë përpara njerëzvet edhe unë dot'a rëfenj atë përpara t'im Eti që është ndë qiej. Matt. 25:34. Atëhere mbret- dot'u thotë atyre që janë nb' anë të së djathtësë Tij. Ejani të bekuarët' e t'im-Eti, trashëgoni mbretërinë që është bërë gatë për ju që kur se është ngrehurë bota.

[3]. Psal. 16:11. Gëzim i plotë është përpara fqinësë s'ate: ndë të djathtët t'ënde është gas kundo.

Pyet. 39. Cila është detyra, që kërkon Perëndia prej njerëzvet?

Përgj. Detyra që kërkon Perëndia prej njerëzvet është t'i bindemi vojësë Tij të çlaqurë.[1]

[1]. Mik. 6:8. Ay të treguoj ty, O njeri, ç'është mirë; edhe ç'kërkon Zoti prej teje, të punosh me drejtëri, të duash përdëllimin, dhe të ecësh i-përunjur me Perëndinë. Luk. 10:28. Edhe ay i tha, u përgjegje drejt: bëj këtë edhe do të rroç.

Pyet. 40 Ç'nom i çlaqi Perëndia, të parën herë njeriut për të bindurit e tij.

Përgj. Nomi që i çlaqi Perëndia njeriut të parën herë për të bindurit e tij është nomi moralI.[1]

[1]. Rom. 2:14-15. Sepse kur gjëntasit që s'kanë nom, punojnë porsë'e nomit pas tisit, këta adhuese s'kanë nom, janë vetë nom në veten të tyre; të cilët dëftojnë punën e nomit shkruarë ndë zëmrat të tyre, sepse ndërgjegja e atyreve martiris bashkë me ata, edhe mendimetë ndërment atyreve përfaqësë a ogërsë tjatë njëri me tjatrinë.

Pyej. 41. Ku është shkruar shkurtazi nomi moralI?

Përgj. Nomi moralI është shkruarë shkurtazi ndë të dhjetat porosi.[1]

[1]. Nam'i Dytë 10:4. Edhe shkroj mbi rasat, pas shkonjësë parë, të dhjetë fjalëtë që u foli juve Zoti ndë malit, nga mesi i zjarrit, ditën të përmbledhjesë: edhe Zoti m'i dha atoe. Matt.19:17. Po ndë do të hyrç në jetët, ruaj porositë.

Pyet. 42. Ç'është të përmbledhurit e të dhjetëvet porosi?

Përg. Të përmbledurit e të dhjetëvet porosi është, të duash Zotin Perëndinë t'ënt me gjithë zemërën t'ënde, edhe me gjithë shpirtin t'ënt, edhe me gjithë mëndjen t'ënde; edhe të afërmin t'ënt posi veten t'ënde.[2]

[2]. Matt. 22:37,40. Edhe Iisuj i tha ati, Të duash Zotinë Perendinë t'ënt me gjithë zemërën t'ënde, edhe me gjithë shpirtinë t'ënt, edhe me gjithë mëndjenë t'ënde. Këjo është porosi e parë edhe e madhe. Edhe e dyta që është sinjëjë me atë është: Të duash të afërmiat t'ënt posi veten t'ënde. Gjithë nomi edhe profitëritë varenë mbe këto dy porosia.

Pyet. 43. Cila është parathënja e të dhjetëvet porosi?

Përgj. Parathënja e të dhjetëvet porosi është këjo: Unë jam Zoti Perëndia yt që të kam nxjerë nga dheu i Egjyptësë, nga shtëpia e sherbesësë[3].

[3]. Të Dalcë 20:2. Unë jam Zoti Perëndia yt, që të kam nxjerë nga dheu i Egjyptësë, nga shtëpia e sherbesësë.

Pyet. 44. Çna mëson parathënjja e të dhjetëvet porosi?

Përgj. Parathënja e të dhjetëvet porosi na mëson se me qënë që Perëndia është Zoti edhe Perëndia ynë edhe çpërblimtari ynë, përandaj kemi detyrë t'i mbajmë të-tëra porosit e Tija.[4]

[4]. Nom'i Dytë 11:1. Duaj pra Zotë Perëndinë t'ënt edhe ruaj të rnajturat' e Atij, e urdhërimet e Atij, e gjyqet e Atij, e porosit e Atij, gjithë ditt. 1 Pet. 1:17,19. Edhe ndë qiojçi Atë atë që gykon pa mbajturë anë pas punësë gjithësecilit, shkoni kohërë me frikë mbë këtë dhe të huajë që cilët duke dëturë se nuk' u çpërblyetë me gjë që prishetë si me argjent a me ar, nga ajo e kota jeta juoj që u kanë lënë juve atërit, po me gjakun e pa-çmuarë të Krishtit, posi qengjit papullavi e pa të shpyerë.

Pyet. 45. Cila është porosia e parë?

Përgj. Porosi e parë është: Mos kesh të tjerë[1] Perëndira veç meje.[1]

[1]. Të Dalët 20:3. Mos kesh të tjerë Perëndira veç meje.

Pyet. 46. Ç'kërkon porosia e-parë?

Përgj. Porosi e-parë kërkon që të dijmë[1] edhe të vërtetojmë se vetëm një Perëndi i vërtetë është: Perëndia ynë,[2] edhe përandaj t'a adhurojmë edhe t'a lavdurojmë.[3]

[1]. 1. Kron. 28:9 Dhe ti, biri im Solomon, njih Perëndinë të prinderit t'ënt, dhë shërbeji Atij me gjithë zëmër edhe me mirë dashje.

[2]. Nemr i Dytë. 26:17. Ke zgjedhurë Zotë sot të jetë Perëndia yt, edhe të ecërsh mb'udhët t'Atij, e të ruash urdhënimet' e Atij, e porosit'e Atij, e gjyqet'e Atij, edhe t'i dëgjosh zënë Atij.

[3]. Ps. 95:6—7. Ejani, letë falemë e let'i bienë ndër këmbë: letë bienë nde gjunjë përpara Zotit, që na krijoj. Se ay është Perëndia ynë: edhe ne jemi llaazi i kullotësë Atij, edhe dhënt'e dorësë Atij. Matt. 4:10. Sepse është shkruarë, Zotit Perëndisë t'ënt dot' i falesh, edhe vetëm Atij dot'i lutesh.

Pyet. 47. Ç'ndalon porosia e parë?

Përgj. Porosia e-parë ndalon të-mohuarit,[1] të-mosadhurtuarit edhe të-moslavduruarit të Perëndisë së-vërtetë si Perëndi,[2] edhe Perëndia ynë,[3] edhe të-dhëmit e adhurimit edhe lavdimit të Perëndisë së-vërtetë një t'jatri, edhe i detyrohet vetëm Atij.[4]

[1]. Ps. 14:1. Tha i mari ndë zëmërë të tij, s'kë Perëndi.

[2]. Rom. 1:20—21. Që të mos mandin ata t'apënë tjatë. Sepse adoruese nishnë Perësdisë, mik'e lavduarë si Perëndi.

³). Po lluani in nukë ndrgjojatsë t'im, edhe Israili s'vuri re.

⁴). Rom. 1:25. Të cilët ndrruanë të vërtetën e Perëndisë me gënjeshtrën edhe adhuruan'e kriut adhurestën më tepër se atë që e ndërroj, i-cili është i bekuarë për gjithë jetët. Amin.

Pyet. 48. Ç'na mëson veçanërisht fjalët *përveç meje*, të porosisë së parë?

Përg. Këto fjalë, *përveç meje*, të porosisë së parë na mësojnë se Perëndia, i cili i sheh të gjitha, vë re edhe i vjen shumë rëndë për fajin që bëjmë dyke pasurë një tjatër Perëndi.⁴

⁴). Ps. 139:1—3. O Zot, më provove, edhe më njeh. Ti njeh të ndejturit t'im, edhe të ngritunit t'im: kuptohen mendimet'e mi që së largu. Vështron të ecurit t'im edhe të dergjurit t'im, edhe njeh gjithë udhët' e mia. Nom'i Dytë 30:19,18. Po unë u kthetë zemëra jote, e të mos bindesh, po të humbur, udhëtë, edhe t'u falesh perëndirave të tjerë, e t'i heç, unë po u zp juve zë sot, se dotë shuhi pa dyshim.

Pyet. 49. Cila është porosia e-dytë?

Përgj. Porosia e dytë është. Mos bësh për veten t'ënde idhullë as të shembëllyerë ndonjë gjë që është lart në qiell, a që është poshtë në dhet, a që është ndee ujërat përposh dheut; mos u falesh as t'i luç: sepse unë Zoti Perëndia yt jam Perëndi zilitar, që shpaguanj fajet e atërvet mbi djemt, gjer mbë të tretin edhe të katrëtin brez atyreve që më kanë mërr; edhe bënj përdëllim mbë mijëra brezash atyreve, që më duanë edhe ruajnë urdhërimet' e mija.⁵

⁵). Të Dalëte 20:4—6. Mos bësh për veten t'ënde idhullë as të shëmbëllyerë ndonjë gjë që është lart në qiell, a që është poshtë në dhet, a që është në ujërat përposh dheut; mos u falesh as t'i luç; sepse unë Zoti Perëndia yt jam Pere-

ndi zilitar, që shpaguanj fajet e zotërvet mbi djemt, gjer më të tretën e të katërtin brez atyreve që më kanë mëri; edhe bëaj përdëllim mbë mijëra Prezash atyreve, që më duanë edhe ruajnë urdhërimet e mija.

Pyet. 50. Ç'kërkon porosia e-dytë?

Përgj. Porosia e dytë kërkon të pritarit, të ruajturit edhe të mbajturit kthjellët edhe fare të-paprishurë ç'do adhurim letar edhe të tëra urdhërimet sikuadrë i ka ndarë Perëndia më Fjalën e Tij të Shënjtëruarë.[1]

[1]. Nom'i Dyte 12:32. Gjithë ç'u urdhëroj unë juve, këtë vështroni të bëni; s'ko për të shtuarë në atë, as ke për të hequrë nga ajo. Matt. 28:20. Edhe i mësoni ata të ruajnë gjithë sa u kam porositur juvë.

Pyet. 51. Çndalon porosia e dytë.

Përgj. Porosia e dytë ndalon të adhuruarit të Perëndisë më të-përgjajtuar,[1] ose më një tjatër mënyrë që nuku eshtë ndarë ndë Fjalën e Tij.[2]

[1]. Rom. 1:22—28. Dyke thënë se janë të mënçim, u marruanë. Edhe ndruanë lavdin'e të pavdërit Perëndi me shëmbëllesë ikone njeriu që vëretë, e shpezësh, e stërsish katrëkëmbësë, e shtërpajsh.

[2]. Kol. 2:18. Asndonjë ko të mos u marë jurc bravurënë me të shtyrë urtësi, edhe me të lutur'ëngjëjsh duke hyrë mb'ato panë që s'ka parë, dyke frytarë veten kot nga mëndja e mishit tij.

Pyetj. 52. Përse jemi urdhëruarë të ruajmë këtë porosi?

Përgj. Këtë porosi jemi urdhëruarë t'a ruajmë, sepse Perëndia ka pushtet mbi ne, edhe ne jemi të tijtë[1]; edhe Ay eshtë zilitar për lavdin'e Tij.[2]

[1]) Ps. 45:11. Se Ay është yt Zot: edhe adhuro Atë. Ps. 100:3 Dini se Zoti është Perëndia: Ay pa bërë edhe ne jemi të tijë: ne jemi komb' i Atij, edhe dhëntë e kullotësë Atij.

[2]) Të Dalëtë 34:14. Sepse s'ke për të luturë tjetër Perëndi: sepse Ay Zoti, që e ka emërin Zilitar, është Perëndi zilitar 1 Kor. 10:22. Apo dot' i shtiemë zilinë Zotit; mos jemi më të fortë se Ay.

Pyetj. 53. Cila është porosi e tretë?

Përgj. Porosia e tretë është, Mos març emërin' e Zotit Perëndisë t'ënt mbë të kotë; sepse Zoti nuku dotë nxjerë pa faj atë që mer emërin' e Atij mbë të kotë.[3]

[3]) Të dalëtë 20:7. Mos març emërin' e Zotit Perëndisë t'ënt mbë të kotë; sepse Zoti nukë dotë nxjerë pa faj atë që mer emërin' e Atij mbë të kotë.

Pyet. 54. Ç'kërkon porosia e tretë?

Përgj. Porosia e tretë kerkon t'i përndorim emërat, titllat, çlarjet,[1] urdhërimet,[2] Fjalën e-Shenjtëruarë,[3] edhe punërat e Perëndisë[4] me shënjtërim edhe me nder

[1]) Ps. 29:2. Epni Zotit lavdin' e emrit Atij: adhuroni. Zeuf. 15:3,4 Të mëdha edhe të çudëshme janë punët e tua, o Zot Perëndi Gjithëpushtetës: të drejta edhe të vërteta janë udhët e tua, o mbret' i shënjtorëvet. Cili nukë dotë kotë frikë ty, o Zot, edhe nukë dotë lavdonjë emërin t'ënt?

[2]) Ekl. 5: 1. Ruaj këmben t'ënde, kur vete në shtëpi të Perëndisë dhe afroju më tepër për të dëgjuar, se sa për të sjellë dhuratën të të marëvet; sepse këta nuka kujtojnë se bëjnë keq.

[3]) Ps. 138:2. Dotë adhuronj ndë tempullin t'ënt të shenjtëruarinë: edhe dotë lavdëronj emërin t'ënt, për përdëllimin t'ënt edhe për të vërtetën t'ënde se madhërove fjalënë tënde më tepër se sa të pat dalë emëri.

[4]) Ps. 104:24 Sa u madhuanë punët' e tua, o Zot! të gjitha i bëre me dituri.

Pyetj. 55. Ç'ndalon porosia e tretë?

Përgj. Porosia e-tretë ndalon të çnderuarit ose të-përndorurit keq të ndonjë gjëje me anë të së-cilës Perëndia dëften vetën e Tij.[1]

[1]. Lev. 19:12. Dhe të mos bëni be në të sarëmbër mbë emërin T'in, edhe të mos çëroni emërin e Perëndisë t'ënt: Unë jam Zoti: Matt. 5:34,35. Të mos bëni be fare: as për qiellinë sepse është fron' i Perëndisë: as për dhenë, sepse është vënd, që të këmbën'e Tija: as për Jerusalimin', sepse është qytet' i mbretit madh.

Pyet. 56. Ç'kanë për të pësuarë ata që shkelin porosin e tretë?

Përgj. Ata që shkelin porosin' e tretë, sindekur meretë vesh nga porosia vetë, ndonëse munt të shpëtojnë nga gjyq'i njerëzvet, Perëndia do të mos i lerë të shpëtojnë nga gjyq' i vërtetë, edhe nga mundimi ndë ditë të pastajme.[1]

[1]. Nom'i Dyte 28:59. Atë-here Zoti dotë bënjë plagët' e tua të frikçme, edhe plagët e farës s'ate të mbëdha e të pa poshtuara edhë sëmundjët të këqia e të pëposhtuara.

Pyet. 57. Cila është porosia e katërtë.

Përgj. Porosia e katërtë është, kujto ditën' e Sabbatësë që t'a shëntërosh atë. Gjashtë dit puno dhe bej gjithë punët' e tua: po e shtata ditë eshtë Sabbat e Zotit Perëndisë t'aut nd' atë dit mos bësh as ndonjë punë, as tij, as yt bir, as jot bijë, as shërbëtori yt, as shërbëtoreja jote, as bagëtia jote, as i huaji yt, që është përbrenda dyerve tua; sepse ndë gjashtë dit Zoti bëri qiellin edhe dhenë, detin, edhe gjithë sa janë n'ato, edhe të shtatënë dit pushoj.[1]

[1]. Te Dalësë 20:8—11. Kujto ditën'e Sabbatësë që t'a shëntërosh atë. Gjashtë dit puno edhe bëj gjithë punët' tua: po e

shtata ditë është Sabbat'e Zotit Perëndisë tënd: nd'atë ditë mos bësh as nënjë punë, as ti, as yt bir, as jot bijë, as shërbëtori yt, as shërbëtorja jote, as bagëtija jote, as i huaji yt, që është përbrënda dyerve tua; sepse në' gjashtë dit Zoti bëri qiellin edhe dhenë, detinë, edhe gjithë sa janë n'ato, edhe të shtatënë ditë pushoj.

Pyet. 58. Ç'kërkon porosia e katërt?

Përgj. Porosia e katërt kërkon të nbajturit me shënjtërim për Perëndinë ato kohëra që i ka ndarë Perndia ndë Fjalën e Tij; veçanërisht një ditë të tërë nga të shtatat, si Sabbatë të Shënjtëruarë, për veten' e Tij.[1]

[1]) Lev. 19:30. Sabatat e mija t'i nbani dhe shëntëroren t'ime t'a nderoni: Unë jam Jehova. Nem'i Dytë 5:12. Ruaj ditën' e Sabbatësë, për të shenjtëruar atë: sikundrë të urdhëroj Zoti Perëndia yt.

Pyet. 59. Cilën ditë nga të shtatat ndau Perëndja, që të jetë Sabbata e përjavëshme?

Përgj. Që më të-nisurit e botës gjer ndë të-ngjallurit e Jisu Krishtit Perëndia ndau të shtatën ditë të javës të jetë Sabbata e përjaveshme[1]; edhe që atëhere e para ditë e javësë u nda të jetë gjer në funt të botësë Sabbata e të Krishterëvet.[2]

[1]) Të Bërët 2:3. Edhe Perëndia'bekoj ditën' e shtatë, edhe shëntëroj atë: sepse atë ditë u prëjt nga gjithë punët' e tia që ndërtoj edhe bëri Perëndia. Të Dalët 16:23. Edhe ay u tha atyre, këjo është ajo që tha Zoti: Nesër është Sabbatë, pushim i shëjtëruarë për Zotinë.

[2]) Punët 20:7. Edhe ditën e parë të javësë kur ishinë mbledhurë (nëmësit) për të thyerë bukënë, Pavli kuvëndonte me ata, sepse kishte për të ikurë nbë të nesërmet. 1 Kor 16:1,2. Edhe për të mledhurit'e aspravet për shëntorëtë, sikundrë urdhërova kishat e Galatisë, kështu bëni edhe ju. Ç' do dit' e

nanë të jetësë gjithësecili prej jush letë vërë mb' ajanë, e letë mbledhë atë që t'ja bënjë mbarë Perëndia. Zbul. 1:10. kesh ndë frymë dilën e dielë.

Pyet. 60. Si duhet të shëntërohet dita e Sabatësë?

Përgj. Sabbata duhet të shenjtëroherë me atë çlodhje të shenjtëruarë tërë atë ditë edhe nga të këtilla punëra edhe dëfrime të botësë që janë të nomta për ditët e tjera[1]; edhe duke skruarë tërë kohën në adhurim të Perëndisë qoftë i botëshme ose i veçantë[2], perveç asaj kohe që duhetë të epetë ndë punëra nevoje edhe përdellimi.[3]

[1] Lev. 23:3. Gjashtë dit të paochet, po dita e shtatë dotë jetë sabbatë çlodhje, dhë e shënjtë, aa gjë të mos bënë; sabbata është e Jehovës në të gjitha të ndenjurat tuaja.

[2] Isa. 58:13,14. Ndë kthesh këmbënë tëndë nga Sabbata, për të bërë dashurimit' e tua ndë ditën t'ime të shenjtëruarën, edhe të quash sabatënë kënaqje, të shënjëruarë ditën' e Zotit të nderçëme, edhe të nderosh atë, të mos vesh pas adhëvet tua, aa të mos gjesh në' atë dashurinë t'ënt, aa mos flaç fjalët' e tua, atëhere dotë kënaqesh mbë Zotë; edhe unë dotë hipënj mbë vëndë të lartër të dhëut, edhe dotë të sehqenj me trashëgimin' e Jakovit t'ët et: sepse goj e Zotit foli.

[3] Cili njeri nga ju dotë jetë ay, që dotë kosë një dele, edhe ndë rënië këjo ndë grop në për ditë të shtunash, nuku dotë a ajrë e t' angrenë atë; Sa më tepër pra nëna njeriu nga dëlja pëcamtaj është e ndhosë të bënjë mirë njeriu për të shtunat. Mark. 2:27. Përandaj u thashtë atyre, se e shtuna është bërë për njerinë po jo njeriu për të shtunënë.

Pyet. 61. Ç'ndalon porosia e katërtë?

Përgj. Ndë porosin' e katërtë na ndalonet të shkruarit ditënë kot, me mendime, me fjalë, e me punëra të kësaj bote; a duke bërë punëra të cilat vetiu janë të fajme[1], pa bërë detyrat që duanë bërë atë ditë[2].

[1]). Ezek. 23:38. Më shumë këtë ata ma bënë mua, ata ndyrë tronë tim të përdëllimit ndë atë ditë, edhe kanë pëgërë sabbatat e mija.

[2]). Jer. 17:21. Kë=htu thotë Zoti; Vini re, edhe mos mbani barë ditën e sabbatës, edhe të mos e silni ndëpër portat e Jerusalimit. Luk. 23:56. Edhe u kthyen' e bënë gati erëra të mira e vajra ere: edhe të shtunë u prëjtnë pas porosisë ronit.

Pyet. 62. Përse është bërë porosia e katërtë?

Përgj. Porosia e katërtë është dhënë për këtë punë: Perëndia na ka dhënë gjashtë dit ndë javët për të mbarnar punëtë[2], edhe na thotë se e shtatta ditë është e Tija[3]. Ay vetë pushoj' nd' atë ditë[4], edhe si e bekoj na la shëmbëllesë të bëjmë edhe ne kështu[5].

[1]). Të Dalëtë 31:15,16. Gjashtë dit të bënetë punë: edhe të shtatënë ditë të jetë sabbatë pushim i shënjtërsuarë për Zotë edhe kush të bëngë punë ditën' e sabbatësë, të vritetë faro. Edhe të bijt e Israilit dotë ruajnë sabbatënë, që t' e kremtëronë atë ndër gjithë brezat e tyre, për dhiatë të përjetëshme.

[2]). Lev. 23:3 Gjashtë dit të punohet, po e shtatta ditë të jetë Sabbatë pushim, atë e shënjtë, as gjë të mos bëni; sabbata është e Jehovësë ndëpër të gjithë stepiat t'uaja.

[3]). Të Dalëtë. Këjo është një shënjë ndërmest meje edhe të bijet e Israilit për kurdo: sepse Zoti bëri qiellin' e dhenë për gjashtë dit, edhe të shtatënë ditë pushoj edhe u preh.

[4]). Të Bërësë. Edhe Perëndia bekoj ditën e shtatë, edhe e shënjtëroj atë.

Pyet. 63. Cila është porosia e pestë?

Përgj. Porosia e pestë ësht, ndero t' ët atë edhe t'ët ëmë që të bënesh jetë-gjatë mbi dhet, që të ep Zoti Perëndia yt[1].

[1]). Të Dalëtë 20:12 Ndero t'ët ëmë, që të bënesh jetë-gjatë mbë dhet, që të ep Zoti Perëndia yt

Pyet. 64. Ç'kërkon porosia e pestë?

Përgj. Ndë porosin' e pestë na urdhëronetë të nderojmë cilin do, ndo më të mëdhenj', ndo më të vegjël[1], ose bara me ne[2]; edhe të bëjmë detyratë t'ona mb' ata.

[1]. Lev. 19:32. Përpara leshit të thinjur të ngrihi, dhe fytyren e plakut t'a ndermi dhe prej Perëndie të kini frikë: Unë jam Jehova t'auj. Ef. 6:1,5. Ju djemtë, i dëgjoni përindyrit tuaj ndë Zotinë: sepse këjo është' e ndhësë. Ju shërbetorëtë t'u dëgjoni zotërit t'auj pas mishit me frikë e me të dridhurë, me zemërën t'auj të mirën, posi Krishtit. Rom. 13:1. Ç'do shpirt let'i ujdi kryetë'pushtetevet larta: sepse s'ka pushtet prej vetia, veç prej Perëndisë: edhe ato (pushtetet) që janë, janë urdhëruarë nga Perëndia.

[2]. Ef. 6:9. Edhe ju zotërinjtë, po ashtu bëni tek ata, e shtinja të frikësuarëve: duke ditunë se edhe ju vetë keni Zot ndë qiell edhe tek Ay s'ka të mbajtur' asnë.

[3]. Rom. 12:10. Dosi tret njëri tjetrinë me dashuri vëllazërie: ju shkoni me nderë njëri tjetrit.

Pyet. 65. Ç'ndalon porosia e pestë?

Përgj. Porosia e pestë ndalon të-mos vënit re ose të bërit gjësendi kundrë nderit ose detyrës që ka ç'do njëri ndë ç'do shkallë ne të cilën gjendetë[1].

[1]. Rom. 13:7—8. U tani pra të gjithëve detyrasë: atij që është për pagesë, pagesënë: atij që është për të pasurë frikë, frikënë: atë që është për të pasurë nderë, nderinë. Asndonjerisë mos i kini detyrë asgjë, veç të dosi njëri tjetrinë: sepse ay që do tjetrinë ka mbushurë nevinë.

Pyet. 66. Ç'të mirë kanë ata që ruajnë porosin' e pestë?

Përgj. Perëndia zotonetë të apë jetë të gjatë edhe të mbarë të gjithëve, ndë qoftë për të mirën' e

tyre edhe për lavdinë e Perëndisë) që ruajtë porosin' e pestë[1].

[1]. Ef. 6:2,3. Ndaro t'ët ata e të t'ënë, e cila është porosia e parë me të zotuarë. Që të bënetë miré ty, edhe të jesh jetë-gjatë mbi dhet.

Pyet. 67. Cila është porosia e gjashtë?

Përgj. Porosia e gjashtë është, mos vraç[1].

[1]. Të Dalëte 20:13. Mos vraç.

Pyet. 68. Ç' na porosit Perëndia në porosin' e gjashtëtë?

Përgj. Në porosin'e gjashtëtë Perëndia na porosit të përdorim ç'do farë mënyrash për të ruajtarë jetënë t'onë[1], edhe jetën'e të fqerëvet[2].

[1]. Ef. 5:29,30. Sepse asnjonjë ndonjëherë s'e mori mëri mishin' e tij, po e ushqen edhe e ngroh, sikundrë edhe Zoti kishënë. Sepse jemi anët'e trupit Atij; prej mishit Atij, edhe prej eshtravet Atij.

[2]. Ps. 82:3,4. Gjykoni dorë-hollisë edhe të varfërin, epni të drejtënë të përunjurit edhe të nevojshmit. Dëftoni të nevojshmitë edhe dorë-hollinë: prej dorësë lajtorevet shpëto ata.

Pyet. 69. Ç' ndalon porosia e gjashtë?

Përgj. Porosia e gjashtë na thotë mos vrasëmë as vetën t'onë,[1] as të afërmin tonë me padrejtëri,[2] as mos bjemë gjë tjatër e cila mund të sjellë të këtillë funt.[3]

[1]. Punët 16:28. Po Pavli thërriti me zë të math, duke thënë, mos i bëj ndonjë të keqe vetes s'ate: sepse ne gjithë jemi këtu.

[2]. Të Bërëtë 9:6. Kush të derdhë gjak njerit, nga njerin dof' i derdhetë gjaku atij. Sepse bërë njerinë pas shëmbëllimit Perëndisë.

[3]. Nom' i Dytë 24:6. Të mos marë njeri për penk gur nuliri, as të sipërmëne as të poshtëmë: sepse mer jetë për penk. Fjalët e Urta 24:11,12. Shpëto ata që biqenë për të vrarë, edhe mos u mërgo nga ata që janë gati për të therur. Ndë thënç, na neve tok nukë dijmë këtë: a nuku e di Ay që peshon zemëratë; edhe Ay që ruan spirtin t'ënt, edhe i ep gjithëcilit pas punëravet atij, a nuk e di. I Ioan 3:15. Kushdo që i ka mëri të vëllai, është njeri-vrasës: edhe e dini se ç'do njeri-vrasës s'ka jetë të pasosurë që mbet mbë veten të tij.

Pyet. 70. Cila është porosia e shtatë?

Përgj. Porosia e shtatë është, mos kurvëronç.[4]

[4]. Të Dhëtë. 20:14. Mos kurvëroni.

Pyet. 71. Ç'na porositet ndë porosin' e shatë?

Përgj. Ndë Porosin' e shtatë na porositet të ruajmë pastrinë t'ënë edhe paqtësinë e të afërmit t'ënë ndë zemërën,[1] ndë fjalë,[2] edhe ndë punët.[3]

[1]. I. Thess. 4:4. Gjithocili prej jush të dijë të mbanjë enen' e tij me shëjtërim e me nder. 2. Tim. 2:22. Edhe mërgoje nga dëshërimat' e djalërisë: po ndiq drejtërinë, besënë, dashurinë, paqtimnë bashkë me ata që therrasënë Zotinë me zemërë të kthjelëtë.

[2]. Ef. 4:29. Ç'do fjalë e kalburë letë mos dalë prej gojesë s'uaj po ajo që është e mirë për ndërtesën e nevojësë.

[3]. Ef. 5:11,12. Edhe mos kini shoqëri ndë punëra të papemë të errësirësë, po më tepër i qërtoni. Sepse ato që punonënë fshehurazi nga ata, është turp të zihen'edhe me gojë. 1. Pet 3:2. Si të shohënë jetënë t'uaj të pastrënë që e shëtoni me frikë.

Pyet. 72. Ç'ndalon porosia e shtatë?

Përgj. Porosia e shtatë ndalon ç'do mendime,[1] ç'do fjalë,[2] edhe ç'do punëra të pa-paqta.[3]

[9]. Matt. 5:28. Po unë po u them juve, se kushdo që vë re gruan me dëshërim, e ka kurvëruarë atë ndë zëmër të tij.

[9]. Ef. 5:4. As turpëri e fjalë të mara a fjalë për gas, të cilatë s'kanë hijë.

[9]. Ef. 4:3. Edhe kurvëri e ç'do ndyrësi, a lakmim, as të mos zihetë në gojë ndër ju, sikundrë u nginjn shënjtorevet.

Pyet. 73. Cila është porosia e tettë?

Përgj. Porosia e tettë është, mos vjethç.[1]

[9]. Të Dhëtë 20:15. Mos vjethç.

Pyet. 74. Ç'na porositet ndë porosin' e tettë?

Përgj. Ndë porosin'e tettë na porositet të fitojmë edhe të shtojmë pasjen edhe nderë t'onë me të drejtë;[1] edhe të ndihim edhe të tjerëtë të bëjnë kështu.[2]

[9]. Fjalët e Urta. 27:23. Shiko të dish se si janë tubt e dhëntet e ty, edhe ki-ju kujdes mbë topëvet.

[9]. Lev. 25:35. Dhe kur vëllaj yt dotë varfëroset, dhe pasja e tij dotë lanàet nëpërsë veje, atëhere ndihmoji, i huaj qofë ose i pashtër; që të rrojë me ty. Nom' i Dytë 15:10. Vërtet t' i apç atij edhe zëmëra jote të mos djaltëzoncië kur t' i apç atij: sepse përmbaj dotë bekonjë Zoti Perendia yt gjithë punët e tua edhe gjithë çkë prish me dorë.

Pyet. 75. Çna ndalonetë në porosin'e tettë?

Përgj. Ndë porosin'e tettë na porositet të mos bëjmë as një farë punë me të cilën ndalojmë veten t'onë,[1] a të alërmin t'onë nga punëra, që apënë nder edhe fitim.[2]

[9]. Kush a bije pengo ngerësvet kot, dotë mbushetë me

vobëzi. 1 Tim. 5:8. Po nëse qofsë ndonjë se nukë mëndonetë më përpara për të tijtë, edhe më fort për të shtëpisë tij, ay ka mohuarë besënë, edhe është më i lik se i pabesi.

[1]. Isk. 5:4. Na te bërtet paga që na keni mbajturë punëtorvet që korrë arratë t'uaja: edhe të bërtiturat' e korrësavet' i vanë adë veshët të Zotit Sabaoth.

Pyet. 76. Cila është porosia e nëntë?

Përgj. Porosia e nëntë është, mos bësh dëshmim të remë kundrë të afërmit tënt.[1]

[1]. Të Dalete 20:16. Mos bësh dëshmim të remë kundrë të afërmit t'ënt.

Pyet. 77. Ç'kërkon porosia e nëntë?

Përgj. Porosia e nëntë kërkon të përmbajturit edhe të përhapurit e së-vërtetës ndë mest të njerësvet,[2] si edhe të emrit t'onë të mirë,[3] edhe të afërmit t'onë,[4] veçanërisht, atëhere kur bëjmë dëshmim.[5]

[2]. Efë. 4:25. Përandaj ini mbë aj'anë gënjeshtërënë, gjithsecili jetë flasë të vërtetënë me të afërmin e tij: sepse jemi copat' e njeri tjatrit.

[3]. 1. Pet. 3:16. Dukë patarë ndërgjegje të mirë që kur të flasënë keq për ju si për njerës keq-bërës, të turpëroenin'ata që u përflasënë jasë për jetën' e mirë që shtoni mbë Krishtënë. Punët 25:10. Edhe Pavli tha, Unë kam ndenjurë përpara gjykatësë Qesarit, atje ku dahetë të gjykoenem. Unë s'u kam bërë ndonjë liq Judhenjvet, sikundrë edhe ti e di fort mirë.

[4]. 3 Ioan 12. Për Dëmitrin epetë murtiri e mirë nga të gjithë edhe nga ajo e-vërteta.

[5]. Fjalët e Urta. 14: 5, 25. Dëshmintari i drejtë nukë dotë gënjenjë, po dëshmintari i rem derth gënjeshtra. Dëshmintari i drejtë shpëton shpirtëra: po i remi derth gënjeshtra.

Pyet 78. Ç'ndalon porosia e nëntë?

Përgj. Porosia e nëntë ndalon të folurit fjalë,

të-cilat çpërnderojnë emërin t'ënë,[1] a të afërmit t'ënë,[2] edhe janë kundrë së vërtetësë.[3]

[1]). 2 Kor. 8:20,21. Duke drunjtuarë për këtë, që të mos na zërë ndonjë me gojë për të keq për këtë eleimosinë të tepërme që u punua prej nesh: sepse kemi kujdes për ato që janë të mira, je vetëm përpara Zotit po edhe përpara njerëzish.

[2]). Ps. 15:3 I cili nuku gënjen me gjuhë të tij, edhe nuk' bën keq fqinjësë tij, edhe nuku pret çpërndorim për të afërmit e tij.

[3]). Kol. 3:9. Mos gënjeni njeri tjatrinë, pasa sveshtë njerin' e vjetërë bashkë me punëtrat'e atij. Fk. 12:3, Zoti thanë gjithë buzëtë gënjeshtare.

Pyet. 79. Cila është porosia e dhjetë?

Përgj. Porosia e dhjetë është, Mos dëshëronç shtëpin'e të afërmit tënt: mos dëshëronç gruan'e të afërmit t'ënt, as shërbëtorin'e atij, a s hërbëtoren'e atij, as kan'e atij, as gomarin'e atij, as ç'do gjë që është e të afërmit t'ënt.[1]

[1]). Të Dalësë 20:17. Mos dësheronç shtëpin'e të afërmit t'ënt mos dëshërnç gruan'e të afërmit t'ënt as shërbëtorin'e atij, as shërbëtoren'e atij, as kan'e atij, as gomarin'e atij, as ç'do gjë që është e të afërmit t'ënt.

Pyet. 80. Ç'kërkon porosia e dhjetë?

Përgj. Porosia e dhjetë kërkon të jemi të-kënaqurë plotësisht me gjëndjen t'onë,[1] edhe të kemi dëshira të drejta edhe të mira për të afërmin t'onë edhe për tërë pasjen e tij.[2]

[1]). Hevr. 13:5. Mëndyra juaj lotë jetë pa lakmim zotjenës: e let'a jenë mjaft ato që këmi adashti: sepse ay ka thënë, Nuku kam për të lënë ty, as nuku kam për të hequr dorë prej teje. 1 Tim. 6:6. Po bes'e mirë me mbastimin' mbë të pakët është ftim i math.

[1]. Lev. 19: 18. Dotë mos març qërblim as të kesh ndonjë murmuri kundër fëmijëvet të popullit tënt, po dotë duash të afërmin tënt si veten tënde. Unë jam Zoti.

1 Kor. 13:4-6. Dashuria ka zëmërë të gjerë, edhe bën të mira: dashuria s'ka çmir: dashuria s' është e rëmbyershme, s' madhështonetë, s'bën punë të shëmtuara, s'kërkon të sajatë vuku zëmëronetë, s'menton të ligënë: s'gëzonete për të shtrëmbrrësë, po gëzonetë për të vërtetënë.

Pyet. 81. Ç'ndalon porosi e dhjettë?

Përgj. Porosia e dhjettë ndalon të qarit për shkaën në të cilën gjëndemi,[1] të pasurit çmir edhe të hidhëruarit kur shohim të afërmin t'onë se është mirë[2]; edhe më se nuku bën të kemi dëshira të liga për ç'do gjë që është e të afërmin t'orë.[3]

[1]. 1 Kor. 10:10. As të murmurisni, sikundër edhe ca vetë aga ata murmurisnë, edhe u prishnë nga prishësi.

[2]. Gal. 5:26. Letë mos kërkojmë 'nedi të kotë, dyke shtytuë njeri tjatrinë, duke pasurë çmir njeri tjatrinë.

[3]. Kol. 3:5. Bëni pra të vdekura pësimënë, dëshërimin' e tik, edhe lakmimin, që është idhullrrë Luk. 5:9. Mos peherëtini njeri tjetrit.

Pyet. 82. A munt ndonjë njeri të mbanjë plotësisht porosit' e Perëndisë?

Përgj. Pas të rënit poshtë të Adhamit as njeri ndë këtë jetë (përveç Krishtit), s'ka mundurë të mbanjë plotësisht porosit' e Perëndisë[1]; po ditë për ditë, i shkel ato me mëndje, me fjalë edhe me punë.[2]

[1]. Rom. 8:8. Edhe sa janë të mishit, nuku munt t'i pëlqejnë Perëndisë.

[2]. Rom. 3:9,10. Sepse edhe Judhenjtë edhe Elinetë të gjithë janë ndënë tuj: sikundrë është shkruarë, se nuk është i drejtë asnjë: Ekkl. 7:20. S'ka as një njeri të drejtë përmbi dhe që bën të mirë edhe nuku fëjen. Rom. 7:19. Sepse nuku bënj

atë të mirënë që dua po punonj atë të koqenë që nuka dua. Të Hëregë 8:21. Sepse mendimi i zëmërës njeriut është i lik që nga fosnjëria e atij. Isa. 3:2. Sepse të gjithë fijejmë mbë shumë punëra. Nëë qëtë se nuka fëjen ndojë me fjalë, ky është bur' i zoturë, i fuqishmë të vërë fre edhe gjithë trupit.

Pyet. 83. A i sheh Perëndia të gjitha të shkelurat e nomit sinjënje?

Përgj. Disa të shkelura nomi, që vet-vetiu,[1] madhojmë të këqiatë janë më të mëdha se të tjerat përpara Perëndisë.[1]

[1]. Ps. 19:13. Edhe nuaj shërbëtorinë tënt prej mudhështish: jotë mos zotëronjmë mbs mua. Ioan 19:11. Iisai u përgjeq. Nuku kishnjo aë ndonjë pushtet mbi mua të mos të qënkë dhënë prej së lartë; përandaj ay që më ep mënë dorët' e tua ka më tepër faj. Ioan 15:22. Të mos kishnjam ardhurë, e të mos u kishnjam folur' atyre, nuku dotë kishinë fëj: po ndështi nuka kanë shkak për fajin e tyre.

[1]. Mat. 11:24. Veç po u thëm juve, se mbë dhe të Sodhomëvet më i durueshmë dotë jetë murdisni ndë ditë të gjykit, se nbi ty. Luk. 12:10. Edhe kushdo që të thotë fjalë kundrë të birit njeriut, dotë i falete: po atij që të vlasfimisnjë kundrë frymësë shënjtëruarë nuk' dotë i falete. Hebr. 10:29. Sa më tepër mundim, u duketë juve, se dotë hequr ay që ka shkelurë me këmbë të Birin e Perëndisë, edhe ka kujtuarë se gjaku i dhiatësë është si ç'do gjak, që me të u shënjtëruа, edhe ka shajtë frymën' e Birit.

Pyet. 84. Ç'është çpagim'i çdo faji?

Përgj. Ç'do faj pret zëmërimin edhe mallëkimin e Perëndisë ndë këtë edhe ndë tjatrënë jetë.[2]

[2]. Gal. 3:10. Sepse sa njerës janë gjej punënash nomit, janë ndëno mallëkim: sepse është shkruarë, I mallëkuar është cilë ktdo që s'qendron mbë gjith ato që janë shkruarë ndë vivli të nomit, për të bër' ato. Isa. 2:10. Sepse ay që të nunojë gjithë nomë, edhe të fijcajë mbë një punë është bërë fajtuar i të

gjithave. Matth. 25:14. Atë-herë dotë tha ther edhe atyre që rinë n' anë të mëngjërë, Iknì prej meje, të mallëkuarëtë, ndë zjarr të pasosurë që është bërë gati për djallin' edhe për ingjëjt' e tij.

Pyet. 85. Ç'kërkon Perëndia prej nesh që të mundim të shpëtojmë nga zëmërimi edhe nga mallkimi që na pret, për fajet që kemi bërë?

Përgj. Për të shpëtuarë nga zëmërimi edhe mallkim' i Perëndisë për fajet që kemi bërë, Perëndia kërkon prej nesh t'i besojmë Krishtit, të pendohemi me gjithë zemërë për fajet,[1] që kemi bërë duke përkujdesurë të përudorim të gjitha mënyrat e përjashtësme me anën e sëcilavet Jisu Krishti na ep të mirat e çpërblimit.[2]

[1] 1. Mark. 1:15. Iksai erdhi ndë Galilea dyke kcjtur' e dyke thënë, pendohi, edhe i besoni ungjillit. Luk. 13:3. Po ndë s-pendohesh, të gjithë kështu dotë humpni. Punët 20:21. Duke dhënë martirì mbë Judhenj e mbë Grekër për pendimbë mbë Perëndinë, edhe për besëmë mbë Zotinë t'onë Jisu Krishtinë, Fil. 2:12. Punoni për shpëtimin' i vetesë t'uaj me frikë e me të dridhurë.

[2] 2. 2 Pet. 1:10. Përandaj, o vëllezër, asëtoni më tepër të sigurohi të thëiturit edhe të zgjedhurit t'uaj. Hevr. 2:3. Qash dotë shpëtojmë neve, ndë përtolshim për këtë tarë shpëtimi të madh, që mori të fillitë prei Zotit, e u vërtetua ndër ne nga ata që e dëgjuanë. Tim. 4:16. Kij kujdes vetesë s'ate edhe mësimit: qendro mb'ato. Segjë ndë bësh këtë dotë shpëtosç edhe vetesë t'ënde edhe ata që të dëgjonjënë ty.

Pyet. 86. Ç'është të mbesuarit mbë Jisu Krishtin?

Përgj. Të mbesuarit mbë Jisu Krishtin është të njoherit e hirit,[3] që na bënetë[4] me anën të së cilës e marim Atë si Shpëtimtarin t'onë,[5] edhe të pasurit shpresë vetëm mbë Atë për shpëtimnë t'onë sikundrë është thënë në ungjillt.[6]

[1]). Punët 16:31. Edhe ata i thanë, Beso-i Zotit Jisu Krishtit edhe dotë spëtoç ti edhe shtëpia jote. Hevr. 10:39. Edhe ne, euku jemi nga ata që hiqenë prapa për prishje, po nga ata që besonjënë për spëtimn' e shpirtit.

[2]). Jean 1:12. Edhe sa e pritnë, u dha pushtet të bënenë bij Perëndije atyreve që besonjënë mb'emerit t'Atij.

[3]). Fil. 3:9. Edhe të gjendem tek ay, pa pasurë drejtërinë t'ime që është nga nomi, po atë që është nga an' e besënë Krishtit, drejtërinë që është prej Perëndisë mbi besë.

[4]). Zbul. 22:17. Edhe ay që do, letë marë dhuratë ujët' e jetësë.

Pyet. 87. Ç'është pendim' i-vërtetë?

Përgj. Pendim' i vërtetë është një hir spëtimi,[1] me anë të të cilit një fajtor duke pasurë një ndjenjë të vërtetë për fajin e tij,[2] edhe duke marë vesh përdëllimin e Perëndisë, që dëftehet me anë të Krishtit,[3] kthenet te Perëndia për shpëtim, me hidhërim edhe me mëzritje për fajin e tij,[4] duke vendosurë edhe duke u përpjekurë, me gjithë zemërë, për bindje të re.[5]

[1]). 2 Kor. 7:10. Sepse hidhërimi sipas Perëndisë bie një pendim për shpëtim të papenduarë: po hidhërim' i botësë bie (sjell) vdekje.

[2]). Punët 2:37. Edhe si dëgjuanë këto, u thyenë zëmërat) e tyre, e i thanë Pietrit edhe apostojvet tjerë, Ç'të bëjmë o burra vëllezër.

[3]). Luk. 1:77-79. Për të dhënë njoftë shpëtimi llaozit atij, me adjesën' e fajevet atyre, me anën të përdëllimit thellë Perëndisë t'onë, që até vuri re të lindurit' e djellit perj së larti, për të ndritur' ata që rinë nd'errësirë e ndë hie të vdekjesë, që të bënjënë këmbëtë t'ona të ecëjnë drejt ndë udhë të paqtënit.

[4]). Jer. 31:18-19. Dëgjova Efraimin duke qarë: Ti më mësove, edhe u mësova si një viç i-panënzazë ndë zgjedhje, kthemë edhe dotë kthehemë, sepse Ti je Jehova Perëndia im; dhe me tëvërtet, se u kthova, u pendova, dhe si u mësova, këllkun më goditi: U turpërova dhe u skuqa, sepse mbajta fajet e djalërisë s'ime.

¹j. Rom. 6:18. Edhe si u liruatë prej fajit, e bëtë shërbëtorët' e drejtërisë!

Pyet. 88. Cilat janë veglat e jashtëzme edhe të përgjithëshme me anën të së cilavet Iisu Krishti na ep të mirat e çpërblimit?

Përgj. Veglat e jashtëzme edhe të përgjithëshme me anën të së cilavet Iisu Krishti na ep të mirat e çpërblimit janë radhët e Tija, a më mirë fjalët e Tija, Sakramentat edhe të faluritë²; edhe të gjitha këto punojnë për shpëtimin' e të sgjedhurvet.

²j. Punët. 2:41-42. Ata pra si pritnë fjalën e Atij, me qëzim u pagëzuanë: Edhe ishinë duke pasurë në mësimë të apostojvet, e në shoqëri, e në të thyerët të bukës, e në të faluritë.

Pyet. 89. Qysh punon fjala e Perëndisë për shpëtimin tonë?

Përgj. Frym' e Shënjtëruarë bën të këndua-rit' e fjalës Perëndisë, a më tepër të lëçiturit të punonjë për të bindurit edhe të kthyrit' e fajtorëvet te Perëndia,¹ edhe për të ndërtuarit, e tyre ndë shënjtërim edhe ngushullim²; edhe të gjitha këto bënenë me anën' e besësë, që sjell shpëtim.³

¹j. Neh. 8:8. Edhe kështu këndonin kthjetër në librë të nomit Perëndisë edhe tregonin mendimin' e nomit edhe kthjetonin ato që këndonin. Iak. 1:21. Prituni me butësinë fjalënë që ka mbirë nëër ju, e cila mund të shpëtonjë shpirtërat t'uaja.

²j. Punët 20:32. U le juve te Perëndia, edhe te fjali e hirit Atij, i cili mund t'u ndërtonjë juve e tu apë trashëgim nëër meet gjith' atyreve që janë të shënjtëruarë. Rom. 15:4. Që të kemi shprosë prej durimit e prej ngushullimit shkrouajavet.

³j. 2 Tim. 3:15. Edhe se i di Shkronjat' e Shënjtëruara që nga fëmijëria ato që mund të bëjnë të dituë për shpëtim me anë të besësë që është mbë Iisu Krishtinë.

Pyet. 90. Qysh duhet të këndohet edhe të ndëgjohet fjala e Perëndisë që të punonjë për shpëtimin t'onë?

Përgj. Për të punuar për shpëtimin t'onë fjala e Perëndisë duhet të këndohet edhe të ndëgjohet me kujdes,[1] me pregatitje,[2] edhe me të falurë,[3] më shumë, duhet të meret me besë,[4] edhe me dashuri,[5] edhe të mbahet ndë zëmërat t'ona,[6] edhe të vihet ndë praktikë në jetët t'onë të përditëshme.[7]

[1] Nom'i Dytë 6:6-7. Edhe këto fjalë që po të urdhëroj më sot, dotë jenë ndë zëmërët t'ënde: edhe dot'ua mësoj me kujdes djemvet tu, edhe dotë flas, për ato kur të rish ndë shtëpit t'ënde e kur të ecësh rrb'udhë, e kur të flesh të flesh, e kur të zgjonesh.

[2] 1 Pet. 2:1-2. Si të hidhni larg, pra ç'do të ligë e ç'do kobim, e ipokrisi, e çmir, e ç'do të folurë keq, posi foshnjë lindurë rishtazë, let' u kotë dëshirë qumështin' e këndelitë të fjalësë, që të ritni prej atij.

[3] Ps. 110:10. Ç'i ayt e mij edhe dotë shoh punët' e mahitëshme prej atenit I Zot.

[4] Rom 1:16. Sepse nukë kam turp për ungjillin' (e Krishtit) sepse është fuqi Perëndie për shpëtim mbë cilin do që beson.

[5] 2 Thes. 2:10. Edhe me ç'do kobim të shtrëmbëtësë, ndërmest atyre që humbasënë: sepse nuku prënë dashurin' e së vërtetësë që të shpëtonjësë.

[6] Ps. 119:11. Kruejta fjalët'e tua ndë zëmërët t'ime, që të mos fëjenj nbë ty.

[7] Isa. 1:25. Po ay që unjet' e shkon ndë nom të thejshtë të së lirësë, edhe qëndron mb'atë si të bëmësë jo asi që dëgjonj e harro, po asi që bën punënë, ky dotë jetë i lumurë ndë punë të tij.

Pyet. 91. Qysh punojnë Fshehësirat për shpëtimin t'onë?

Përgj. Fshehësirat punojnë për shëtimin t'onë,

nuku se ka ndonjë fuqi ndër ato, ose nde ay që i ep[1]; po vetëm me anën'e hirit Krishtit edhe të punuarit e Frymësë së Shëntëruarë, ndër ata që i marrinë me besë.[2]

[1]. Pet. 3:21. Kundra-forma e atij është pagëzimi që na shpëton edhe neve tashti (jo të hedhurit tej e pastrimi i mishit, po matlitia e ndërgjegjesë mirë mbë Perëndinë,) me anë të ngjallurit të Jesu Krishtit. Rom. 2:28-29. Sepse nuk'është Judhe ay që duket për faqe: po ay që është ndë të fshehurë Judhe

[2]. 1 Kor. 12:13. Sepse neve të gjithë jemi pagëzuarë prej njerësë Frymë ndë një trup, a Judhenj a Grekë, a robër a të liruarë: edhe të gjithë jemi ujiturë mbë një frymë

Pyet. 92. Ç'do me thënë Fshehësirë?

Përgj. Fshehësirë do me thënë një nadhë e shëntëruarë, që e ka lënë vetë Krishti, ndë të cilën me ca shënja të përjashtësme, Krishti edhe të mirat e dhjatësë së re përfytyrohen, vërtotëhen edhe u epen besëtarëvet.[1]

[1]. Matt. 28:19. Shkoni pra e mësoni gjithë kombetë, edhe i pagëzoni mb'emërit t'Atit e të Birit e të Frymës Shëntëruarë. Matt. 26:26-28. Edhe sita kur ishinë dyke ngrënë, Jesui mori bukënë, edhe si e bekoj e theu e u'a dha nxënësvet, edhe tha, Merni e hani: ky është trupi im. Edhe mori potirinë edhe si u fal-aderë, e a dha atyre, duke thënë, pini të gjithë prej këtij; sepse ky eshtë gjaku im i dhiatësë re, që derdhetë për shumë për ndjesën'e fajevet. Rom. 4:11. Edhe mori shënjën' e rethprerjasë për nalë drejtërije t'asaj besësë që është ndë parethprerjesë.

Pyet. 93. Cilat janë fshehësirat e dhiatësë re?

Përgj. Fshehësirat e dhjatësë re janë pagëzimi,[1] edhe darka e Zotit, që është kungimi.[2]

[1]. Punët 10:47–48. Mos mund të ndalojë njeri ndonjë, që të mos pagëzonemë këta që marrënë Frymën' e Shënjtëruarë si-kundrë edhe neve? edhe i urdhëroj të pagëzonemë mbë emërit të Zotit.

[2]. 1 Kor. 11:23–26. Sepse un' e mora nga Zoti atë që u thashë edhe juve, se Zoti Iisu nëp'atë natë që dotë epej adër dear, mori bukë, edhe si u fal-ndersë theu edhe tha, Meni e hani: ky është trupi im që thyhetë për ju: këtë bëni për kujtimnë t'im. Kështu edhe gotinë, pasi kishtë darkuarë, duke thënë, Ky gotir është dhiatë e re ndë gjakund t'im: kotë bëni, sa herë të pini, për kujtimin t'im. Sepse sa herë të hani këtë bukë, edhe të pini këtë gotir, dëftoni vdekjen' e Zotit, gjer mbë atë kohë që të vinjë.

Pyetj. 94. Ç'është pagëzimi?

Përgj. Pagëzimi është një Fshehësirë, e cila, me të larëtë nd'ujë m'emërin' e Atit, të Birit e të Frymësë së Shënjtëruarë,[1] shëmbëllen edhe vërteton se ne jemi të bashkuarë me Krishtin, edhe se kemi pjesë ndë të gjitha të mirat që vinë pas dhiatësë hirit[2]; edhe dëftëu se kemi vendosurë të jemi githënjë të Zotit.[3]

[1]. Matt. 28:19. Shkoni pra e mësoni gjithë kombet, duke i pagëzuar nëp' emrit t' Atit e të Birit e të Frymësë së Shënjtëruarë. Iuan 3:5. Iisuj u përgjeq. Me të vërtet me të vërtet po u them, Nëse nuk lindet njeriu prej ujit e prej Frymësë s'mund të hynjë ndë mbretënrit të Perëndisë.

[2]. Rom. 6:3,5. A nuku e dini se sa u pagëzuarë mbë Iisu Krishtinë, u pagëzuarë mbë vdekjen t'Atij. Sepse sikundër neve, u bënë një bisë bashkë me atë pas shëmbëllimit vdekjes' Atij do të jemi edhe pas shëmbëllimit të ngjallurit dake dituré këtë.

[3]. Gal. 3:27. Sepse sa jemi pagëzuarë mbë Krishtinë keni veshurë Krishtinë.

Pyet 95. Cilëtë duhetë të pagëzohenë?

Përgj. As njëri nga ata që janë jashtë kishësë Krishtit nuku bën të pagëzonetë, pa rëfyerë besën' e

ti mbë Krishtinë edhe u bindarë ndëu'Atë?; po djemt' e atyreve që janë anëtarë të kishësë Krishtit lipsetë të pagzoheuë?.

[1]. Punet 18: 8. Edhe Krispi i pari i sinagogjësë i bëroj Zotit me gjithë shtëpinë e tij edhe shumë vetë nga Korinthianët, dyke dëgjuarë besonin edhe pagëzoneshinë.

[1]. Të Bëretë 17:7,10. Edhe dotë vë dhiatënë t'ime ndërmest meje edhe teje, e farësë s'ate pas teje mbë brezat për dhiatë të përbereshme, që të jem Perëndi te tij edhe te fara jote pas teje. Këjo është dhiata ime që dotë ruani ndërmest meje e juve, edhe farësë s'ate pas teje: Ç'do-mashkull prej jush dotë rethpritetë. Punët 2:38,39 Atë-herë Pietri u tha atyreve, pendohi, edhe gjithesecili prej jush letë pagëzoiettë mb'emërit të Iisu Krishtit për ndjesën e fajeve: edhe dotë merni dhuratën e Frymës së Shejtëruarë; sepse të zotuarit është për ju edhe për djemt t'uaj, edhe për gjith ata që janë larg, sa ka për të thirurë Zoti Perëndia ynë. 1. Kor. 7:14. Sepse burr i pa besë është shëjtëruarë nga gruaja: edhe gruaja e pabesë është shëjtëruarë nga burri: sepse tjetrazi bijtë t'uaj do të ishinë të pëgët-të; po tashi janë të shëjtëruarë.

Pyet. 96. Ç'është kungimi?

Përgj. Kungimi është aji fshehtësirë, e cila, me të dhënët edhe me të marët bukëu edhe verëu, pas urdhërimit Krishtit, shëmbëllehet vdekja e Atij?; edhe pritësit e vëyerë bënenë, jo ndë punë, po me anëu e besës tyre, pjesëtarë të trupit edhe të gjakut Krishtit bashkë me të gjitha të mirat'e tija, që janë për të yshqyerë shpirtin edhe për të riturit e tyre ndë hir.?

[1]. 1 Kor. 11: 3-26. Sepse un'e mora nga Zoti atë që u dhashë edhe juve, se Zoti Iisu mb'atë natë që do të vpej ndër duar, mori bukë, edhe si u falë-ndërsë thoi edhe tha, merni e hani: ky është trupi im. Kështu edhe potirinë, pasë kishte darkuarë, duke thënë, Ky potir është dhiata e re ndë gjakun t'im: këtë bëni sa herë të pini, për kujtimin t'im. Sepse sa herë të hani këtë bukë, edhe të pini këtë potir, deftoni vdekjen'e Zotit, gjer mb'atë kohë që të vinjë

[1] Punët 3:21. Të cilin duhet t'a presë qjelli gjer mbë atto kohëra që të vihenë mbë vënt gjith' ato që foli Perëndia që jetën' e gjatë me anë të gojësë gjithë shënjtorëvet tij profitërvet 1 Kor. 10:16. Ay potiri i bekimit që bekojmë, a nuk'është kungimi i gjakut Krishtit? Apo buka që thyemë, a nuk' është kungim' i trupit Krishtit?

Pyet. 97. Ç'duhetë të bëjmë për të qënë të zotë të marim pjesë ndë darkë të Zotit?

Përgj. Për të qënë të zotë të marimë pjesë ndë darkën e Zotit, duhetë të vështojmë veten t'onë, a e çquajmë trupin e Zotit; a kemi besë mbë të yshqyerit mbë Të; a jemi penduarë për fajet t'ona a kemi dasheri edhe a u bindemi udhërimevet Perëndisë; sepse ay që ha e pi pa bërë këto ha e pi gjykimin (për dëm) për veten e Tij.[1]

[1] 1 Kor. 11:27,31,32. Përandaj ay që të hajë këtë bukë, a të pijë këtë potirin' e Zotit, pa qën' i vyerë, dotë jetë fajtuar i trupit edhe i gjakut Zotit. Po njerëzia letë vështonjë veten e tij, e kështu letë hajë nga ajo bukë, edhe letë pijë nga ay potir. Sepse ndë shqyrtin veten t'onë, s' dotë gjykonesh[i]n. Po kur gjykonemi, mundonemi proj Zotit, që të mos gjykonemi për të keq bashkë me botënë. Rom. 6:17,18. Po i falemi-nderse. Perëndisë, sepse qetë ajchërë shërbëtorët' e fajë, po ndashti i dëgjuatë me gjithë zemërë formësë mësimit, që u dhatë ndër duar mbë atë. Edhe si u liruatë proj fajit bëtë shërbëtorët' e drejtërisë.

Pyet. 98. Ç'është të faluritë?

Përgj. Të falurit është të qfaqurit e dëshërimevet t'ona përpara Perëndisë[1] mbë emërin' e Zotit Krisht[2] për punëra që janë pas vojës Tij,[3] dyke rëfyerë përpara Atij fajet t'ona,[4] edhe duke ja falurënderse për të gjitha përdëllimet që na bën.[5]

[1] Ps. 10:17. Ndigjove dëshërimit' e përunjesit, o Zot; dotë bërç gati zemërën e aturve, dotë dëgjonç me vesnë t'ënt.

Ps. 145:19. Bën dasurinia' e atyreve që i kanë frikë, edhe ndëgjon' lutjen' e atyreve, edhe i shpëton.

[1] Ioan 16:23 Me të-vërtet, me të-vërtet po u them juve, se sa të kyni Atit mb' emrit t'im dot' ua apë juve.

[2] Ioan 5:14. Edhe ky është kusuri që kemi tok Ay se ndë kyçim gjë pas dasturimit Atij na dëgjon.

[3] 1 Ioan 1:9. Nëpërsëm fajet t'ona, është besëtar edhe i drejtë që të na falejë fajet, edhe të na qëronjë nga ç'do e strëmbësë.

[4] Filip. 4:6. Mos kini kujdes as për ndonjë gjë; po kurdo letë njihemë kërkimet t'naja te Perëndia me të falurë-nderë nga të falurit e nga të lutsit.

Pyet. 99. Ç'regullë na ka dhënë Perëndia që të na tregonjë si lipset t'i falemi?

Përgj. Tërrë Fjala e Perëndisë na mëson si duhet t'i falemi Atij[1]; po regulla e veçantë për të udhëhequrë neve është ajo formë lutje që ja u mësoj Krishti nxënësvet tij, edhe, e cila radhazi quhetë lutje e Zotit.[2]

[1] Rom. 8:26. Kështu edhe Fryma vetë na ndih ndë sëmundjet t'ona; sepse nuke dijmë për ç'farë gjëje të falemi sikundër egjan, po ajo Frymë vetë lutetë për ne me pshërëtima të pandjera zëmrë. Ps. 119:120.

[2] Matt. 6:9-13. Po ju falli kështu. Ati ynë që je ndë qiell, u shenjtëruftë emëri yt; mbrëtëria jote; u bëftë dashuria yt si, ndë qiell, edhe mbi dhet; bukënë t'onë të përditëshmen' ep-na e neve sotz edhe falna fajet t'ona, sikundrë edhe neve u a falim fajtorevet t'anë: edhe mos na shtjerë ndë ngasje, po shpëto na nga i ligu; sepse jotja është mbrëtëria e fuqia e lavdia ndë jetët të jetëvet. Amin.

Pyet. 100. Ç'na mëson parëthënija e lutjes Zotit?

Përgj. Parëthënja e lutjes Zotit, e cila është, Ati ynë që je ndë qiell, na mëson të afëronemi përpara Perëndisë me nder edhe me besë të plotë, sikundër

djemt'e bindurë aftësonenë pranë atit tvre, i cili është të i fortë edhe gati të na ndihnjë edhe na mëson t'i falemi,[1] edhe për të tjerëtë, edhe bashkë me këta.[2]

[1] Luk. 11:13. Kur ju pra që jeni të liq dini t'u epni bijvet tuaj të dhëna të mira, sa më tepër Ati që është prej qiellit dot' apë Frymë të Shënjtëruarë atyre që të lupiot prej Atij? Rom. 8:15. Sepse s'keni marë frymë roberie, që të keni frikë përsëri, po keni marë frymë birërie, me anë të cilësë thërresimë Abba, o Atë.

[2] Tim. 2:1-3. Lutem pra, së pëpara nga të gjitha të bëhenë të lutura, të falura, të lëdura, të fëlura-nderse, për gjithë njerëzit, për mbretër, për gjithë sa janë ndë shkallë të lartë, që të shkojmë jetë të pa trazuarë e të bukë me c'do faro besë të mirë e të bleshme.

Pyet. 101. Përse i falemi Perëndisë ndë kërkimin' e parë?

Përgj. Ndë kërkimin'e parë, i cili është, u shënjtëroftë emëri yt, i falemi Perëndisë të na ndihnjë edhe neve edhe të tjerëvet që t'a lavdurojnsë me c'do punë që na çfaqetë,[1] edhe të përndornjë c'do punë për lavdimin' e Tij.[2]

[1] Ps. 67:1-3. Perëndia na përdëlsetë, e na bekoftë; ndritë faqen'e Tij mbë nel Selah. Që të njihet udha jote ndë dhet, shpëtimi yt ndër gjithë kombet. Letë të lavdurojnë laoret, O Perëndi; letë të lavdurojnë gjithë kombet.

[2] Rom. 11:36. Sepse prej Atij, edhe me anë t'Atij, edhe nd' Atë janë të gjitha; më' Atë qoftë lavdia për gjithë jetët. Amën. Zbul. 4:11. I vëjyerë je, o Zot, të març lavdin'e nderin'e faqinë; sepse Tij i kriove të gjitha, edhe për dasharimin t ënt janë, edhe u krisanë.

Pyetj. 102. Përse i falemi Perëndisë ndë kërkimn' e dytë?

Përgj. Ndë kërkimin e dytë, i cili është, Arthtë mbretëria jote, i falemi Perëndisë të prishetë mbre-

tërla e Satanajt,[1] të përhapetë mbretëria e hirit Perëndisë,[2] edhe të na marë e të na ruanjë ndë atë, edhe neve edhe të tjarëtë[3]; edhe mbretëria e Atij më shpejt të vinjë.[4]

[1] Ps. 68:1. U ngritë Perëndia, edhe u përadalsitë armiqt e Atij, edhe ikëinë proj syvet Atij ata që e kanë urrë. Ivan 12:31. Ndashti është gjyq i kësaj botë; ndashti undhëstar i kësaj bote dotë hidhetë jashtë.

[2] Matt. 9:37,38. Të korurit është të shumë, po punëtorët janë të pakë. Lut-i-ni pra të-zotit të-korurit, që të nxjerë punëtorë, për të korurit e Tij.

[3] 2 Thess. 3:1. Mbë të pastajmenë, o vëllezër, lutí për na që të ecënjë fjala e Zotit edhe të lavdërohetë, sikundrë edhe te ju. Rom 10:1. Vëllezër, dëshërimi i zembrës sëime edhe lutja që bënj mbë Perëndinë për Izraillaë, është për shpëtim t'atyre.

[4] Zbuk. 22:20. Po vërj shpejt. Amin. Po, eja, o Zoti Jisu.

Pyet. 103. Përse i falemi Perëndisë ndë kërkimin' e tretë?

Përgj. Nde kërkimin' e tretë, i cili është, u bëftë dashurimi yt si ndë qiell edhe mbi dhe', me i falemi Perëndisë, që me anën'e hëri Tij, të na apë fuqi edhe dëshirë të mjaftëmë, të ndëgjojmë, edhe t'i bindemi kundobërë vojesë Tij, ndë të gjitha gjëra,[1] sikundrë bëjnë engjëjtë ndë qiell.[2]

[1] Matt. 26:39. Po jo si të dua unë, po si të duash Ti. Filip. 1:9-11. Edhe për këtë falem, që të shpëronjë dashuria juaj edhe më shumë e më shumë ndë të njohur e ndë ç'do të adjerë: që ta shqetni ato që ndajnë njëra proj tjatërës, edhe të jeni zemër-kthjellëta e të pa pengueë gjer mbë ditën të Krishtit, plot me pemë drejtësie, që janë me anë të Jisu Krishtit, për lavdi e për nderë të Perëndisë.

[2] Ps. 103:20,21. Bekoni Zotnë, ju të gjithë engjëj' e Atij, të fortë me fuqi, ju që bëni fjalen'e Atij, ju që ndëgjoni zën'e fjalëvet Atij. Bekoni Zotnë, ju gjithë fuqi' e Atij; ju punëtorët'e Atij, që bëni dashurimin' e Atij.

Pyet. 104. Përse i falemi Perëndisë ndë kërkimin' e katërtë?

Përgj. Nde kërkimin' e katëtë, i cili është, Bukësë t'onë të përditëshmen ep-na e neve sot, ne i falemi Perëndisë të na apë pas hirit Tij, gjithë ç'na duhetë sot, nga të mirat e kësaj bote[1]; edhe të gëzojmë bekimin e Tij bashkë me ato.[2]

[1]. Fjalët e Urta 30:8,9. Të mos më apësh as varfëri as pasje; ushqemë me pak ushqim; se mos ngjinjem, e të mohoj, e them, ç'është Zoti? A, se mos ndodhem i varfer, e vjedh, e zë emërin e Perëndisë t'im mbë të kotë. 1 Tim. 6:6-8. Po bes' e miré me mbastimine mbë të pakët është fitim i madh. Sepse as gjë s'kemi prurë ndë botë; edhe e kupëtojmë fort mirë se as nukë mund të marrëmë gjë jashtë me vete. Po kur kemi të ngrena e të mbuluara, këtë na mbasëtojëmë këtë.

[2]. Fjalët e Urta, 10:22. Bekim' i Zotit bën të pasurë, edhe ad'atë nuku dosë shtesë hidhërim.

Pyet. 105. Përse i falemi Perëndisë ndë të pestën kërkim?

Përgj. Ndë të pestin kërkim, i cili është, edhe fal-na fajetë t'ona, sikundër edhe ne u a falim fajtorëvet t'onë, ne i falemi Perëndisë të na falnjë të gjitha fajetë mbë emërin e Krishtit[1]; edhe këtë punë kuxojmë t'a kërkojmë se edhe ne me anën e hirit Tij, mudtmë me gjithë zemër t'u a falim fajetë atyreve që na kanë lëjyerë.[2]

[1]. Ps. 51:1,2,7. Përdëlsmë o Perëndi pas të madhit përdëllim t'ënt, edhe pas të shumëtit të dhëmpçuravet tua shuaj pa-ndërit'e mëja. Laj-më tepërë prej paudhërisë s'ime, edhe më qëro prej fajit t'im. Spërkatmë me hisop edhe dotë qëronem; laj-më edhe dotë bëmem më i bardhë se dëbora.

[2]. Mark. 11:25. Edhe kur të rrei të fill, ndjeni, në paçi gjë kundrë ndonëj, që edhe Ati juaj, që është ndë qjejt t'u shjenjë juve fajetë t'uaja. Matt 18:35. Kështu edhe im Atë qiellori, dot'u a hënjë juve, ndë mos us falçi, prej zëmbrësë s'naj gjithsi-cilë të vëllat të tij fajet e atyre.

Pyet. 106. Përse i falemi Perëndisë ndë të gjashtin kërkim?

Përgj. Ndë të gjashtin kërkim, i cili është, edhe mos na shtjerë ndë ngasje, po shpëtona ngá i ligu, ne i falemi Perëndisë të na ruanjë të mos biemë ndë ngasje[1]; edhe të na mbanjë edhe të na shpëtonjë kur gjëndemi ndë ngasje.[2]

[1]. Matt. 26:41. Rini zgjuarë edhe faluni, që të mos hyni ndë ngasje: sepse shpirti është i gatishmë, po mishi është i pafuqishmë. Ps. 19:13. Edhe ruaj shërbëtorin t'ënd prej modheshtish; letë mos zotëronjënë mbi mua; atëhere dotë dal faqebardhë, edhe dotë qëroncm mrej fajit math.

[2]. Jcan. 17:15. Nuku të lutem t'i nguesh ata nga bota, po t'i ruanç nga i-ligu. 1 Kor. 10: 3. Tjatër të nguc nuk' a ka gjeturë juve, përveç njerëzishte; po Perëndia është besëtar që nuku dot'u lerë juve të ngjiteni më tepër se sa mundni po bashkë me të ngarë dot'u ngë edhe të dëni që të runtni të durosi.

Pyet. 107. Ç' na mëson fund' i lutjesë Zotit?

Përgj. Fund' i lutjesë Zotit, e cila është, sepse jotja është mbretëria, edhe fuqia, edhe lavdija, ndë jetë të jetëvet, amin, na mëson të marim zemërë ndë të falurit, edhe të shprejmë vetëm mbë Perëndinë,[1] edhe ndë lutjet t'ona t'a lavdërojmë Atë duke mbesuarë se e Tija është mbretëria edhe fuqija edhe lavdia[2]; edhe, më ndë funt, për dëshmim se dëshërojmë të na ndëgjonjë edhe se na është mbashurë mëndja që na ndëgjon, thëmi Amin.[3]

[1]. Dan. 9:18,19. Sepse ne nukë sjellim lutjet t'ona përpara Teje nga shkaku i drejtërivet t'ona, po vetëm për mëshirat e Tua të shumëta. O Zot, ndëgjo; o Zot, ndje; o Zot ndëgjo edhejbëj; mos mëso, për Ty, o Perëndia im, sepse yni emërit t'ënt emërohen fortesa jotc edhe populli Yt.

[2]. Filp. 4:6. Po kurdo letc njihenë kërkimet t'uaja te Perëndia me të falura-ndërsë nga të falurit e nga të luturit. I

Kron. 29:11-13. Jotja, o Zot, është madhëria, edhe fuqia edhe pavdia edhe vlerta edhe lartësia: Sepse të gjitha ndë qjell edhe mbi dhet janë të Tuat; jotja, o Zot, është mbretëria edhe Tij je i lartësuar si krye përmbi të gjitha. Edhe pasja edhe nderi prej Teje vijnë;edhe ti je Zot përmbi të gjitha, edhe ndë dorë bënde qëndron fuqia edhe forca, ndë dorë t'ënde qëndron që t'u rritësh fuqi të gjithavet. Dhe tashi, Perëndia yné, të falemi-ndersë edhe lavdërojmë emërin t'ënt të çkëlqyerë.

¶. 1 Kor. 14:16. Ay që ri ndë vënt të padëgurit qysh dotë thotë Amin, kur tij fiesh-ndersë, sepse ay nuku di se ç'thuaë? Zbul. 22: 20, 21. Edhe ay që martisis për këto thotë, po vinj shpejt: Amin. Po eja, o Zot Iisu. Hiri i Zotit t'ënë Iisu-Krishtit qoftë bashkë me ju të gjithë. Amin.

Të Djettë Porositë

Të Dalëtë Kry' e XX.

Perëndia foli gjithë këto fjalë, dyke thënë, Unë jam Zoti Perëndia yt, që të kam nxjerë nga dheu i Egjyptesë, nga shtëpia e skllavërisë.

1. Mos kesh të tjerë perëndira veç meje.

2. Mos bësh për veten t'ënde idull, as të përgjasjurë ndonjë gjëje që është lart ndë qjell, a që është poshtë ndë dhet, a që është ndër ujërat përposh dheut; mos u falesh, as t'i luç; sepse unë, Zoti Perëndia jut jam Perëndi zilitar, që çpaguanj fajet e atërvet mbi djemt, gjer mbë të tretin edhe të katërtin bres atyreve që më kanë mëri; edhe bënj përdëllim mbë mijëra brezash atyreve që më duanë, edhe ruajnë urdhërimet e mija.

3. Mos març emërin e Zotit Perëndisë t'ënt mbë të kotë; sepse Zoti nukë dotë nxjerë pa faj atë që mer emërin e Atij mbë të kotë.

4. Kujto ditën e Sabbatësë, që t'a sënjtëronç atë. Gjashtë dit punò, edhe bëj gjithë punët e tua; po e shtatta ditë është Sabbata e Zotit Perëndisë t'ënt; nd'atë ditë mos bësh a-ndonjë punë, as tij, as yt bir, as jot bijë, as shërbëtori yt, as shërbëtorja jotë, as bagëtija jote, as i huai yt, që është përbrënda dyervet tua; sepse ndë gjashtë dit Zoti bëri qiellin edhe dhenë, detin edhe gjithë sa janë nd'ato, edhe të shtatën ditë pushoj.

5. Ndero t'ët atë e t'ët emë, që të bënesh jetë gjatë mbi dhet, që të ep Zoti Perëndia yt.

6. Mos vraç.

7. Mos kurvëronç.

8. Mos vjethç.

9. Mos bësh dëshmim të remë kundrë të afërmit tënt.

10. Mos dëshëronç shtëpin'e të afërmit t'ënt; mos dëshëronç gruan'e të afërmit t'ënt; as shërbëtorin'e atij, as shërbëtoren'e atij, as kan'e atij, as gomarin'e atij, as çdo gjë që është e të afërmit t'ënt.

Lutja E Zotit

Mattheu VI.

Ati yne që je ndë qiell, u shënjtëroftë emëri yt, arthtë mbretëria jote; u bëftë dashurimi yt, si ndë qiell, edhe mbi dhe; bukënë t'one

të përditeshmen' ep-na e neve sot; edhe fal-na fajetë t'ona; sikudrë edhe neve u'a falim fajtorëvet t'anë; edhe mos na shtjerë ndë ngasje, po shpëtona nga i-ligu sepse jotja është mbretëria e fuqia e lavdia ndë jetët të jetëvet; Amin.

Mbesimi Apostolik

Mbesonj mbë Perëndinë, Atin e Tërëfuqishim, Krietarin e qiellit edhe të dheut: Edhe mbë Birin e Tij të vetëm, Iisu Krishtin, Zotin t'onë; i cili u mishërua prej Frymësë së Shënjtëruarë, i cili u lint prej vërgjëreshës Mari, i cili vojti ndë kohë të Pondit Pillat, u kryqëzua, vdiq dhe u varua; edhe zbriti ndë skëterë; të tretën dit u ngjall nga vdekja; u naltësua ndë qiell, edhe ri më të djathtën dorë të Perëndisë, Ati i Tërëfuqishmë dhe dotë vinjë përsëri që të gjykonjë të gjallët edhe të vdetunt.

Mbesonj mbë Frymën e Shënjtëruarë kishën e Shënjtëruarë të Përgjithëshme; bashkimin e shënjtorëvet; ndjesën e fajevet; të ngjëllurit e trupit; edhe jetën e përjetëshme. Amin.

FUNT

BKSH

BKSH